Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
25

HAPËSIRA, KOHA dhe DRITA e JUSUF GËRVALLËS



1.Hapësira—Materia

1-1.Hapësira në kuptimin fizik,
1-2.Pauli-Ausschlussprinzip (Principi i përjashtimit)
1-3.Vendi në mes Adem Demaçit e Metush Krasniqit
1-4.Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh,
1-5.Një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh,
1-6.Një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh,
1-7.Një poliglot mes gjuhëtarësh,
1-8.Një këngëtar dhe komponues mes artistësh,
1-9.Një kitarist mes fshatarësh,
1-10.Januz Prekazi dhe Xhafer Durmishi-Skender
1-11.Lëvizja Kaçake e Kosovës LKK
1-12.Lëvizja Kombëtare e Kosovës LKK
1-13.Lëvizja Kombëtare Shqiptare LKSH
1-14.Lëvizja Ilegale LI
1-15.Lëvizja Ideale e Idealistave pa Ideologji LIII
1-16.Shokët e ideve
1-17.VENDI I MADH - VENDI I NDERIT
1-18.Marksistët me ide në kokë dhe marksistët me knizhica në xhep

2.Koha

2-1.Koha fizike, koha biologjike dhe koha psikologjike
2-2.Matja e kohës
2-3.Dragoi Ketë Avdia dhe Zanat e zanafillës
2-4.Shkenca
2-5.Artet
2-6.Shkrimi i historisë është një sintezë në mes shkencës dhe artit
2-7. Klepsidra, Danilo Kish dhe Jusuf Gërvalla
2-8.Orët e ndalura përgjithmonë në Shkup dhe Shtutgart
2-9.Shkallët-hapat e kufizuar në matematikë, logjikë dhe juridikë
2-10.Tri këshillat e policisë amerikane
2-11.Forca e fjalës së parë, fishkëllimës së parë dhe kokorizja e fundit
2-12.Historia e Kosovës, e popullit shqiptar nuk mund të shkruhet pa Jusuf Gërvallën!
2-13.Kardinali Richelieu, Samuel Johnson dhe James Murray
2-14.Rëndësia e të stazhit-kohës së punës
2-15.Me ngut - me alarm
2-16.MADHËSIA E PJESËS DHE MADHËSIA E SË TËRËS
2-17.Kuptimi i ngjarjeve dhe kuptimi i kohëve
2-18.Puna ime intelektuale si individ i lirë
2-19.Adem Jashari dhe Imer Berisha
2-20.Iluzioni i qëndrueshëm

3-Drita

3-1.Ndriçimi i mendjes-Iluminizmi
3-2.Fjalët e qiririt
3-3.YJET E PASHUARA TË RESUL BEDOS
3-4.IK O NATË PO KËNDON AGIMI
3-5.Ylli i pashuar në qiellin shqiptar
3-6.YJET E PAVDEKËSISË së Faridin Tafallarit
3-7.Shuarja dhe vdekja e yjeve si burim jete

3-8.DIELLI
3-9.Drita
3-**10. DIGA E DRINIT dhe DRITA E DRINIT**

1.Hapësira—Materia

1-1.Hapësira në kuptimin fizik

- Jusuf Gërvalla ka lind më 1 tetor 1945, në Kosovë. Në Kosovë është rritur, formuar dhe kalitur personaliteti i tij ashtu siç e njeh sot populli ynë. Në Kosovë - ku e ka kaluar 94% të jetës së tij - ka qenë anëtarë i disa bashkësive, ka pasur vend në disa bashkësi, por përcaktuese dhe vendimtare për jetën e tij ka qenë;

-vendi i tij si anëtarë në bashkësinë kombëtare shqiptare, (nga lindja-prindërit) dhe

-vendi i tij si anëtarë në organizatën Lëvizja Nacionalçlirimtare - LRBSH-LNÇKVSHJ, (në bazë të zgjedhjes së vetë të lirë, aktive, vullnetare dhe personale).

1-2.Pauli-Ausschlussprinzip (Principi i përjashtimit)

Universum apo gjithësia është tërë hapësirë-koha (spacetime) dhe çdo gjë që ekziston në te, duke përfshi të gjitha planetet, yjet, galaxet, përmbajtjen në hapësirën ndër galaktike, pjesët më të vogla përbërëse të atomeve, dhe tërë materia me energjinë. Terma të ngjashëm janë kosmos, realiteti dhe natyra.

Vlerësohet se diametri i universit që mund të vrojtohet ka një diametër prej afërsisht 93 miliard vite drite (lightyears). Vrojtimet shkencore të universit kanë sjellur në disa konkludime për etapat e mëparshme. Këto vrojtime tregojnë se universi është drejtuar nga ligje fizike dhe konstanta gjatë pjesës më të madhe sasiore dhe historike. Teoria Big Bang është modeli i tanishëm kosmologjik që përshkruan zhvillimin e mëhershëm të universit, që vlerësohet se ka filluar prej afër para 14 miliardë vitesh.

Universi përbëhet nga 4,9% materie atomike, 26,6 % materie e zezë (*dark matter*) dhe 68,5% energji i zezë (*dark energy*).

Wolfgang Ernst Pauli, i lindur më 25 prill 1900 në Vjenë, ka vdekur më 15 dhjetor 1958 në Zurich, në Zvicër, ka qenë një fizikan austriak.

"In quantum mechanics, the ***Pauli exclusion principle*** *(German: Pauli-****Ausschlussprinzip****) states that two or more identical particles with half-integer spins (i.e. fermions) cannot simultaneously occupy the same quantum state within a system that obeys the laws of quantum*

mechanics. This principle was formulated by Austrian physicist Wolfgang Pauli in 1925 for electrons, and later extended to all fermions with his spin–statistics theorem of 1940."

Ky princip është i rëndësishëm në fizikë pasi vendosë kushtet për *particles* prej të cilëve përbëhet gjithë materia: elektronet, protonet dhe neutronet. Ky princip është baza e shumë vetive të materies, prej stabilitetit të shkallës së lartë deri tek vetit e elementeve të sistemit periodik, pasi ai vendosë për numrin e elektroneve në çdo mbështjellje elektronike.

Bosonet, që është lloji tjetër i *particles*, ku përfshihen *particles* që ndërmjetësojnë- bartin forcat, si p.sh. fotonet (rrezet e dritës) nuk përfshihen nga *Pauli exclusion principle.*

1-3.Vendi në mes Adem Demaçit e Metush Krasniqit

Adem Demaçi **Jusuf Gërvalla** **Metush Krasniqi**

Adem Dema-*Demaçi:* ***"Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."***

Xhafer Durmishi: "*Është meritë e Sabri Novosellës që e organizoi Jusuf Gërvallën në Lëvizje, i cili i vuri aftësitë e tija fizike, mendore dhe intelektuale në shërbim të atdheut, në mënyrë të organizuar."*

Shefik Sadiku: "*Metush Krasniqi ishte përpjekur, me tërë qenien e tij, që energjitë atdhedashëse të të gjithë veprimtarëve, pa dallim ideje, t'i shkrijë në dobi të çështjes kombëtare, për Shqipërinë.*

Se puna e tij ishte në frymën e bashkimit kombëtar, e paraqes një fakt konkret: Metushi organizoi një pritje të ngrohtë në shtëpinë e vet, në Dajkoc të Dardanës, më 2, 3 dhe 4 shtator të vitit 1974, bashkë me Adem Demaçin, Mulla Ramë Govorin, Hyrije Hanën, Ahmet Haxhiun, Selman Ramadanin, Fehmi Bajramin, Sylë Krasniqin (pleqnar), Hazir Krasniqin (kushëri). Në këtë takim ishin edhe Ilmi Ramadani, student, si dhe Emin e Besnik Krasniqi, nxënës.

Nga këto biseda me ndjenja të larta atdhedashurie u arrit marrëveshja e pajtimit në ide e veprime dhe u vendos që të vazhdohet lufta nacionalçlirimtare e Kosovës e viseve tjera në ish-Jugosllavi vetëm me një "Platformë Politike Kombëtare", as në të majtë e as të djathtë, nga i cili takim, në vitin 1974, do të lind "Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës" dhe, më vonë,

LNÇKVSHJ-ja e viteve 1976/77." (Me rastin e shënimit të 35 vjetorit të Heroit, Metush Krasniqi, kjo kumtesa u lexua ne Tryezën e mbajtur më 15.10.2021 në Prishtinë. E organizuar nga Këshilli Organizativ "Pranvera Shqiptare '81"!)

Jusufi arratiset nga Kosova më 14 dhjetor 1979. Në Gjermani, në Ludwigsburg, në banesë të Bardhit, arrin një javë më vonë, nga ora katër e mëngjesit, ditën e premte, më 21 dhjetor 1979.
Në Gjermani Jusufi jeton nga 21 dhjetori 1979 deri më 17 janar 1982, do të thotë rreth 6% të jetës së tij.

Në përqindje raporti i pjesëve kohore është Kosovë 94% -- Gjermani 6%.
Pra në bazë të fakteve të mësipërme rrjedhë shumë qartë, si drita e diellit, se kemi të bëjmë vetëm me një jetë, vetëm me një Jusuf. Jusufi i gjendur në Gjermani nuk pikë nga qielli por mbërrinë nga toka e nga brumi i tokës së Kosovës dhe merret me një punë të vrullshme e cila lulëzon shpejtë në rrethanat e lira të Gjermanisë, të cilën punë terrori serb nuk mund ta pengoj menjëherë por arrinë ta ndërprejë jetën e tij pas dy vitesh, me atentat, ndërsa punën dhe frymëzimin nga puna e tij nuk ka masë as terror që mund ta ndërprej, kufizoj, izoloj e kontrolloj.
Në këtë kuptim mund të themi pa fijen e dyshimit se shprehjet e mëposhtme:

Babain e kam njohur vetëm në Prishtinë.
Duhet të kthehem atje për ta rinjohur.
Jashtë nuk ka qenë i njëjti.
Ai për mua kishte humbur në Gjermani.
(Sabri Hamiti, Misioni, Prishtinë 1997, f. 88-89)

Janë shumë të gabuara e të pa baza dhe jo vetëm kaq.

Një renditje e një lloji tjetër që është me interes, forma të cilat më ka rënë t'i dëgjojë si deklarata gojore prej disa vetave, lidhur me disa bashkësi ku ka bërë pjesë Jusuf Gërvalla, e ku mund të nxjerrim diskutime edhe për relacionin Prishtinë-Shtutgart, mund ta shohim në këtë fjali të zgjeruar që ndeshet me shkrim e me gojë:

"*Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh, një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh, një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh, një këngëtar dhe komponues mes artistësh, një kitarist mes fshatarësh, një poliglot mes gjuhëtarësh"*

1-4.Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh,
1-5.Një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh,
1-6.Një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh,
1-7.Një poliglot mes gjuhëtarësh,
1-8.Një këngëtar dhe komponues mes artistësh,
1-9.Një kitarist mes fshatarësh,

Renditjen numerike të bashkësive e kam bërë unë.
Prej gjashtë bashkësive mund të themi se vetëm bashkësia numër 1
1- Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh,
ka të bëjë edhe me Kosovën edhe me Gjermaninë-Evropën.

Bashkësia nën numër 1, si më lartë don analizë të veçantë dhe këtë do ta bëjë në formë më të zgjeruar se këto të tjerat (se bashkësitë 1-5--1-9).

Por që tani për bashkësitë 1-5--1-9 mund të japim disa karakteristika të përbashkëta.

Bashkësitë 1-5 - -1-9 i kanë apo i nënkuptojnë tri veti kryesore e që janë:

1.Barazia
2.Inklusiviteti dhe
3.Homogjeniteti

1-4.Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh,

Jusuf Gërvalla është veprimtar i Lëvizjes ilegale. Të gjithë veprimtarët kanë qenë anëtarë të Lëvizjes ilegale. Lëvizja ilegale përbëhet prej anëtarëve të barabartë që e trajtojnë njëri tjetrin si të barabartë. Jusuf Gërvalla nuk është asgjë tjetër pos si cilido anëtarë i Lëvizjes ilegale. Nga kjo automatikisht rrjedh se cilido anëtar i Lëvizjes ilegale është si Jusuf Gërvalla. Nga kjo rrjedh se Lëvizja ilegale është homogjene. Të gjithë aktivistët meritojnë dhe përfshihen brenda saj. Asnjë aktivist i vetëm nuk mbetet jashtë saj.

Jusuf Gërvalla është i Madh për shkakun më themelor se gjendet i padallueshëm në mesin e idealistave të mëdhenj e të pa ideologji.

1-5.Një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh,

Jusuf Gërvalla është një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh. Të gjithë shkrimtarët përkthyesit janë letrar të barabart, i takojnë një kolektiviteti e kolegjialiteti në mes të barabartëve. Jusuf Gërvalla nuk është asgjë tjetër pos si cilido shkrimtar dhe përkthyes. Nga kjo automatikisht rrjedh se cilido shkrimtar, përkthyes dhe letrar është si Jusuf Gërvalla. Nga kjo rrjedh se shkrimtarët dhe përkthyesit përbëjnë një tërësi homogjene të rrethuar prej një muri e portash të larta, brenda të cilave mund të hyjnë vetëm shkrimtarët, përkthyesit dhe letrarët. Si përfundim, për shkrimet e Jusuf Gërvallës mund të flasin vetëm shkrimtarët, përkthyesit dhe letrarët. Vetëm shkrimtarët, përkthyesit dhe letrarët ia dinë vlerën Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla është i Madh për shkakun më themelor se gjendet i padallueshëm në mesin e shkrimtarëve, përkthyesve dhe letrarëve të mëdhenj e të pa ideologji.

1-6.Një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh,

Jusuf Gërvalla është një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh. Të gjithë krijuesit dhe kritikët janë të barabart, i takojnë një kolektiviteti e kolegjialiteti në mes të barabartëve. Jusuf Gërvalla nuk është asgjë tjetër pos si cilido krijues dhe kritik. Nga kjo automatikisht rrjedh se cilido krijues dhe kritik është si Jusuf Gërvalla. Nga kjo rrjedh se krijuesit dhe kritikët përbëjnë një tërësi homogjene të rrethuar prej një muri e portash të larta, brenda të cilave mund të hyjnë vetëm krijuesit dhe kritikët. Si përfundim, për shkrimet e Jusuf Gërvallës mund të flasin vetëm krijuesit dhe kritikët. Vetëm krijuesit dhe kritikët ia dinë vlerën Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla është i Madh për shkakun më themelor se gjendet i padallueshëm në mesin e krijuesëve dhe kritikëve të mëdhenj e të pa ideologji.

1-7.Një poliglot mes gjuhëtarësh,

Jusuf Gërvalla është një poliglot mes gjuhëtarësh. Të gjithë poliglotët e gjuhëtarët janë të barabart, i takojnë një kolektiviteti e kolegjialiteti në mes të barabartëve. Jusuf Gërvalla nuk është asgjë tjetër pos si cilido poliglot e gjuhëtarë. Nga kjo automatikisht rrjedh se cilido poliglot e gjuhëtarë është si Jusuf Gërvalla. Nga kjo rrjedh se poliglotët e gjuhëtarët përbëjnë një tërësi homogjene të rrethuar prej një muri e portash të larta, brenda të cilave mund të hyjnë vetëm poliglotët e gjuhëtarët. Si përfundim, për gjuhën e fjalimet e mbajtura nga Jusuf Gërvalla mund të flasin vetëm poliglotët e gjuhëtarët. Vetëm poliglotët e gjuhëtarët ia dinë vlerën Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla është i Madh për shkakun më themelor se gjendet i padallueshëm në mesin e poliglotëve e gjuhëtarëve të mëdhenj e të pa ideologji.

1-8.Një këngëtar dhe komponues mes artistësh,

Jusuf Gërvalla është një këngëtar dhe komponues mes artistësh. Të gjithë këngëtarët dhe komponuesit - artistët janë të barabart, i takojnë një kolektiviteti e kolegjialiteti në mes të barabartëve. Jusuf Gërvalla nuk është asgjë tjetër pos si cilido këngëtar dhe komponues e artistë. Nga kjo automatikisht rrjedh se cilido këngëtar dhe komponues e artistë është si Jusuf Gërvalla. Nga kjo rrjedh se këngëtarët-komponuesit-artistët përbëjnë një tërësi homogjene të rrethuar prej një muri e portash të larta, brenda të cilave mund të hyjnë vetëm këngëtarët-komponuesit e artistët. Si përfundim, për muzikën e Jusuf Gërvallës mund të flasin vetëm këngëtarët-komponuesit e artistët. Vetëm këngëtarët-komponuesit e artistët ia dinë vlerën Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla është i Madh për shkakun më themelor se gjendet i padallueshëm në mesin e këngëtarëve-komponuesve e artistëve të mëdhenj e të pa ideologji.

1-9.Një kitarist mes fshatarësh,

Këtu prishet rregulli i paraqitjes së Jusuf Gërvallës nga mesi i vet. Pika e mësipërme e sqaroi se kënga në tërësinë e saj kuptohet vetëm nga komponuesit e artistët.

Fshatarët nuk dinë çka është kënga e vërtetë e muzika e vërtetë.

Në një film për Mozartin, nga viti 1984, kur ai e prezanton idenë e tij për operën *Die Entführung aus dem Serail,* para perandorit Josef II, shtrohet çështja se në cilën gjuhë të përgatitet opera. Një prej këshilltarëve të perandorit thotë se duhet të jetë italishtja pasi gjermanishtja është tepër e vrazhdë dhe e pagdhendur për këndim.

Në këtë kuptim mund të themi fshatarët e dinë çka është kitara por janë të pagdhendur për t'i kuptuar tingujt e saj.

Në të njejtin stil, lidhur me atë se në cilën bashkësi Jusuf Gërvalla bënë pjesë (post mortum), në Gjermani, apo në të cilën do ta ndiente veten më së miri është citati si më poshtë:

Pal Sokoli: "*Emocione zgjoj edhe akti kur unë (Pal Sokoli) në marrëveshje me kryetarin z. Martin Çuni dhe kryesinë e LSHAKSH-së (LIDHJA E SHKRIMTARËVE ARTISTËVE DHE KRIJUESVE SHQIPTARË) në Gjermani shpalli vendimin për anëtarësimin, (post mortum) në Lidhjen e shkrimtarëve, artistëve dhe krijuesve shqiptarë në Gjermani, e dy figurave të ndritshme të kombit tonë; patriotin, poetin dhe artistin;* ***Jusuf Gërvalla****, si edhe albanologun, linguistin, shkrimtarin modern, dhe pedagogun e urtë prof.* ***Martin Camaj.*** *Salla e duartrokiti në duke qëndruar në këmbë disa minuta, këtë vendim të qëlluar. Në skenë e ftova z. Martin Çuni, që në emër të LSHAKSH-së në Gjermani, fletë anëtarësimin me emër të Jusuf Gërvallës të ja dorëzoi bijës së tij, Donikë Gërvalla.* ***Donika e pranoi e emocionuar dhe tha: "Ju falënderoj përzemërsisht për këtë akt, dhe e besoj se po të ishte gjallë Jusufi, askund nuk do ta ndjente***

veten më mirë së në gjirin e kësaj Lidhje..”. (LSHAKSH dhe SH.I.H.K- Shoqata Integruese Humanitare dhe Kulturore Stublla, nderuan trinomin Gërvalla dhe Zeka; www.zemrashqiptare.net, 6 maj 2012)

Përveç barazisë dhe homogjenitetit brenda secilës bashkësi mund të themi se ekziston një llojë barazie e homogjeniteti brenda tërësisë së të gjitha bashkësive, pra marrë të gjitha bashkësitë së bashku.

Në mënyrë matematikore pjesët, bashkësitë:

1-Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh,
2-një shkrimtar dhe përkthyes mes letrarësh,
3-një krijues dhe kritik i saj mes kritikësh,
4-një poliglot mes gjuhëtarësh,
5-një këngëtar dhe komponues mes artistësh,
6-një kitarist mes fshatarësh,

duket sikur janë të barabarta në mes veti.

Nga sa është parashtruar më lartë rrjedhin dy lloje konkluzionesh për periodizimin e jetës së Jusuf Gërvallës.

1. Jusuf Gërvalla është edukuar, në tokën shqiptare nga veprimtarët e lëvizjes ilegale, shkrimtarët, përkthyesit, letrarët, krijuesit, kritikët, poliglotët, gjuhëtarët, këngëtarët, komponuesit, artistët, kitaristët dhe fshatarët. Nga ky mjedis e nga këto kryqëzime rrugësh e idesh bëhet i popullarizuar në memorien e popullit, bëhet pronë e kujtesës kolektive.

   Rrethanat, si rezultat i luftës së popullit shqiptar për liri, më 21 dhjetor 1979 e sjellin në Gjermani. Krejt dituritë e tij të fituara me dekada i shtin në përdorim me guxim dhe mjeshtëri deri në atë masë sa për dy vite shteti jugosllav nuk mund t’ia ndal hovin e tij me çfarëdo metodash të propagandës dhe me asnjë agjentë të cilit do lloj e kalibër të kenë qenë, dhe kundër tij e përdorë mjetin e fundit që e ka në dispozicion, vrasjen me atentat që e kryen më 17 janar 1982.

   Fati, rrethanat dhe shorti i ka rënë Jusuf Gërvallës ta kryej me nder e me lavdi atë punë e atë detyrë që e ka kryer.

   Në mungesë të Jusuf Gërvallës, ajo detyrë, ai fat, ai short do të binte mbi cilin do qoftë veprimtar, shkrimtar, përkthyes, letrar, krijues, kritik, poliglot, gjuhëtar, këngëtar, komponues, artist e kitarist, dhe cilido prej tyre, cilido prej nesh do ta kryente atë detyrë me po aq nder e lavdi sikurse Jusuf Gërvalla.

Këtë lloj interpretimi e quaj më të drejtë, më realist, dinamik dhe më të ndershëm pamvarësisht se çka mendojnë personat e ndryshëm.

Por ekziston edhe varianti i dytë tek disa intelektual në Kosovë, variant statik të cilin më ka rënë ta lexoj, që po e përmbledhi si më poshtë.

2. Jusuf Gërvalla është edukuar, në tokën shqiptare nga shkrimtarët, përkthyesit, letrarët, krijuesit, kritikët, poliglotët, gjuhëtarët, këngëtarët, komponuesit, artistët, kitaristët dhe fshatarët. Nga ky mjedis e nga këto kryqëzime rrugësh e idesh bëhet i popullarizuar në memorien e popullit, bëhet pronë e kujtesës kolektive.

Ka ndodhë kështu pasi në Jugosllavinë e Titos, ka lulëzua kultura, kanë lulëzuar shkrimtarët, përkthyesit, letrarët, krijuesit, kritikët, poliglotët, gjuhëtarët, këngëtarët, komponuesit, artistët e kitaristët. Ky lulëzim ka qenë përjetësisht i garantuar. Për këtë garantojnë intelektualët e mëdhenj të cilët nuk janë asgjë tjetër pos antenat e popullit, që dallohen për largpamësi deri në

të gjitha qoshet e skutat më të errëta të globit tokësor. Prej këtij lulëzimi ka pasur dobi shumë të madhe Jusuf Gërvalla, dhe duke qenë i rrethuar nga intelektual të mëdhenj është bërë i madh. Ndaj këtij lulëzimi është treguar mosmirënjohës, duke mos besuar në përjetësinë e tij, ka vepruar kundër të mirave që e kanë rrethua, dhe është arratisur në Gjermani.

Në Gjermani nuk ka gjetë shkrimtar, përkthyes, letrar, krijues, kritikë, poliglotë, gjuhëtarë, këngëtarë, komponues, artistë e kitarist, nuk ka gjetur njerëz të mëdhenj.

Në Gjermani e ka gjetë një moçal të grupacioneve politike, të përbërë nga analfabetë, provokator e agjent. Ka gjetur punëtor e grupe njerëzish, mërgimtarësh me qëllime të mira, por të vegjël, që si ka njohtë askushi, disa hiça prej hiçi.

Dijet dhe kapitalin e pastër dhe të madh kulturor të fituar në Kosovë e ka bërë rrush e kumbulla në Gjermani, në ruletin e ideologjive. Duke kaluar kohën me njerëz të vegjël është bërë i vogël. Ka ra pre, viktimë e grupeve të analfabetëve, provokatorëve dhe agjentëve, të cilët e kanë vra për inate personale e xhelozie.

Me arratisjen e tij e ka ndërpre prosperitetin e tij personal, rrugën me u bërë një shkrimtar, përkthyes letrar, krijues, kritik, poliglot, gjuhëtar, këngëtar, komponues, artist e kitarist shumë më i madh se sa ka qenë në dhjetor 1979. Me hapat e tij e ka ndërpre këtë rrugë prosperuese, duke humbur jetën dhe me këtë i ka shkaktuar dhimbje të madhe familjes dhe kolegëve të tij të mëdhenj, të vërtetë shkrimtarë, përkthyes, letrar, krijues, kritikë, poliglotë, gjuhëtarë, këngëtarë, komponues, artistë e kitarist, të vetmëve persona që kanë ditur me e vlerësua si duhet.

Këtë lloj interpretimi më ka rënë ta lexoj.

***

Po vazhdoj me trajtimin e bashkësive kulturore, se ku ka bërë pjesë Jusuf Gërvalla. Trajtimin apo përkatësinë në bashkësinë -Lëvizja ilegale- e bëjë më vonë pasi është temë më e komplikuar.

Nëse një shkrimtar, shkruan apo flet për Jusuf Gërvallën si shkrimtar, nuk ka asgjë të keqe. Është sjellje shumë e mirë.

Nëse një përkthyes, letrar apo person prej profesioneve tjera kulturore shkruan apo flet Jusufin nga prizmi e fusha e specialitetit të tij, jo që nuk ka asgjë të keqe por është mirësjellje shumë e madhe.

Nëse Ilir Shaqiri, Arif Vladi, Shkurte Fejza e Shyhrete Behluli, Motrat Mustafa, Zyle Krasniqi, Fanushe Ahmeti e të gjithë këngëtarët që e kanë mbajtur dhe e mbajnë kulturën shqiptare të gjallë, e që nuk mund t'i emëroj e as kurrë t'i harroj, duan të flasin për Jusufin si këngëtar jo që nuk ka asgjë të keqe por është kulmi i mirësjelljes, sepse me këtë ata duan të thonë se pas secilit këngëtar fëshehet një Jusuf Gërvallë.

Po ndalem në dy raste për të bërë dy ilustrime.

Më ka rënë të shoh një program, disa herë në Radio Televizionin e Kosovës, ku një trupë e RTK, me rastin e përvjetorëve këndojnë për heronjtë e për Jusufin dhe në skenë pranë këngëtarëve qëndron një kitarë "pa të zotin". Aludimi është tek kitara e Jusufit. Përmes kitarës dërgohet mesazhi i dhimbjes se në skenë dhe grupit të këngëtarëve u mungon Jusuf Gërvalla.

Kjo përgatitje, interpretimi dhe simbolika është një prej gjërave më të bukura që më ka ra të shoh në RTK e në përvjetore.

Ibrahim Rugova në vitin 2003, e patë shprehur një ide për një çmim "Kitara e artë" për hir të Jusuf Gërvallës. Ka pasur një reagim të Sabri Novosellës kundër idesë së I. Rugovës, që për mendimin tim, reagimi (në pjesën rreth Kitarës), në thelb më është dukur i drejtë.

Si është e mundur që dy ide shumë të ngjashme në pamje me nxitë reagime të kundërta jo vetëm tek unë.

Nëse shoqatat muzikore preferojnë të ngrisin lartë aspektet artistike e muzikore të Jusuf Gërvallës, është e drejtë e tyre, është e ndershme dhe nuk ka pse t'i mbetet hatri askujt.

Por e kundërta është kur një politikan (edhe pse me një të kaluar 100% kulturore) don me e afirmua Jusufin si kitarist. Kjo nuk ka si kuptohet ndryshe përveçse:

-Sfera e politikës e e luftës për Kosovën më takon mua I. Rugovës.

-Sfera e muzikës e kitarës të mbetet ty Jusuf.

Pra dallimi është thelbësor.

Këngëtarët janë inklusiv. Ata thonë: Ne dhe Jusuf Gërvalla i takojmë një bashkësie.

I.Rugova është ekskluziv. Ai thotë: Unë dhe Jusuf Gërvalla u takojmë bashkësive të ndryshme. Ka mundësi që I.Rugova nuk e ka shikuar çështjen kështu, por është shumë vështirë me e kuptua ndryshe.

Pra nganjëherë ka rëndësi jo vetëm se ÇKA THUHET por thelbi mund të qëndroj në atë se prej CILIT DREJTIM po vjen fjala.

E njejta deklaratë prej një drejtimi mund të jetë shumë e mirë dhe fisnike dhe prej një drejtimi tjetër mund të jetë e padrejtë dhe e papranueshme.

Pra veprimtarët e luftës për liri, veprimtarët politik duhet treguar shumë respekt për njerëzit e kulturës, kur ata disa gjëra i shohin me prizmin e aktivitetit kulturor.

Por personalitet e kulturës duhet treguar vëmendje, jo rivalitet, durim dhe mirëkuptim kur luftëtarët e lirisë, -pamvarësisht se a kanë fjalor më të kufizuar a jo-zjarrri në zemrat e tyre nuk është më i pakët-, flasin për Jusuf Gërvallën në radhë të parë si ideolog i çështjes kombëtare.

Shokët e luftës e kanë për obligim ta bëjnë këtë në radhë të parë. Nëse këta luftëtarë nuk e kryejnë detyrën e tyre dhe merren me makinacione kulturore -të pa zarar-, ka shumë mundësi që komplimentet e tyre të mos merren në asnjë mënyrë tjetër pos si dredhi e kopili, apo në rastin më të mirë - budallaki.

Është traditë që në vlerësime e vepra, si në art dhe shkencë, sidomos ata që kanë dhënë jetën për popullin, të identifikohen me veprën më të mirë. Çdo krijues që bënë disa vepra i dallon disa me të cilat ai është më i kënaqur. Jusuf Gërvalla ka menduar dhe ka shkruar shumë konkretisht se kurora e veprimtarisë së tij është vepra e tij e shkruar si luftëtarë i lirisë.

1-10.Januz Prekazi dhe Xhafer Durmishi-Skender

Idriz Mehmeti: "*E kom pasë nja (celulë-shën. i Xh.D.) të ndërtume në Mitrovicë me ni djalë i Prekazit, ni Januzin. Atëherë quhej Mustafa, tash e ka mbiemrin Prekazi jeton në Zvicër. Kam pasë kontakt edhe taman jam kyçë në celulë në tresh me Januzin edhe me Xhafer, Xhafer Durmishi, i Stanovcit. Pat ikë mrena pak ditëve se i kishin pa pasë shumë treshe kjo lidhje edhe kjo ka qenë e OMLK-së. Ma vonë kom ni, kanë thanë, "Jo…" baca Sabri Novosella i ngatërron këto, "jo, këta janë konë Marksist-Leninista" diçka i bojnë do shkëputje. Xhafer Durmishi ka qenë sikur unë Marksist-Leninist, çka u bo ma vonë nuk e di."* (Intervistë me Idriz Mehmetin, Oral History Kosovo, 14 mars 2022)

Pas pranverës 2023, më ka rënë ta shikoj në YouTube një intervistë të Oral History Kosovo, e dhënë më 14 mars 2022, nga Idriz Mehmeti. Në intervistë I.M. gënjen në mënyrën më të paskrupullt se unë dhe Januz Prekazi paskemi qenë në një celulë të OMLK-së të Idriz Mehmetit. Çdo fjalë e Idriz Mehmetit në citatin e mësipërm është gënjeshtër e paskrupullt. E njejta vlen edhe për gënjeshtrat e tij në libër që ma ka komentua Januz Prekazi, por vetë nuk kam pasur rastin ta lexoj.

Januz Prekazin e kam njohur në Mitrovicë prej vitit 1977, pesë vjet më heret para se me u njoh me Idriz Mehmetin. Në Pranverë 1981, Januz Prekazi më ka njohur me Idriz Mehmetin. Edhe pse kam qenë i organizuar në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës nga viti 1978, nuk i kam folur konkretisht për këtë asnjëherë Januzit edhe pse jam njohur shumë afër me te, e kemi qenë *cimera* për një kohë në fakultet. Për këtë nuk i kam folë as Idriz Mehmetit. Me I. M. jam njohur për një kohë të shkurtë, e kam takuar disa herë dhe ka qenë në shtëpinë time. Kurrë nuk i kam folur për ndonjë organizatë e as nuk më ka folur për kurrfarë organizate. Kur Januz Prekazi është larguar nga Kosova dhe ka shkuar tek vëllezërit e vetë në Hamburg, më ka kontaktuar shpejt, dhe më vonë kur është vendosur në Zvicër kam pasur kontakte me te. Kurrë në jetë sa kemi komunikuar e bashkëpunuar unë e Januzi nuk ma ka thënë asnjë fjalë për Idriz Mehmetin si individ, dhe kurrë në jetë nuk ia kam thënë unë asnjë fjalë për Idriz Mehmetin sepse nuk kam bërë asnjë punë të vetme politike me te.

Kurrë në jetën time nuk kam qenë në celula të OMLK-së e as anëtar i OMLK-së. Nga kjo rrjedh se kurrë në jetë nuk kam mund me qenë izdajnik i OMLK-së. Ky gënjeshtar që gënjen e më kualifikon si izdajnik të celulës e izdajnik të knizhicës duhet të merret vesh me shokët e vetë. Për epilogun e ideve të OMLK-së kan dhënë mendime udhëheqësit e Idriz Mehmetit dhe koha. Ato mendime gjenden edhe në librat e mi dhe nuk e kam ndërmend të flas këtu. Vepra ime e pastër nuk mund të njolloset, vidhet e përvetësohet.

Në Perëndim, së bashku me Jusuf e Bardhosh Gërvallën
-kemi qenë anëtarë të Organizatës: Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi-LNÇKVSHJ
dhe kurrë
-nuk kemi qenë celulë, kandidat apo anëtarë të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës –
-OMLK-së e të Frontit të OMLK-së,

-nuk kemi qenë anëtarë të organizatës fantazmë **-Lëvizja Kaçake e Kosovës LKK,**
-nuk kemi qenë anëtarë të organizatës fantazmë **-Lëvizja Kombëtare e Kosovës LKK,**
-nuk kemi qenë anëtarë të organizatës fantazmë **-Lëvizja Kombëtare Shqiptare LKSH**,
-nuk kemi qenë anëtarë të organizatës fantazmë **-Lëvizja Ilegale LI**,
-nuk kemi qenë anëtarë të organizatës fantazmë **-Lëvizja Ideale e Idealistave pa Ideologji.**

1-11.Lëvizja Kaçake e Kosovës LKK

Në periudhën e sundimit të gospodinave komunist-marksist-leninist të Jugosllavisë në tokat shqiptare nuk ka ekzistue për asnjë moment një organizatë konkrete me emrin konkret,

-Lëvizja Kaçake e Kosovës LKK, emërtimi i së cilës sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes bëhet me germa të mëdha. Ky emër nuk gjendet në asnjë rast të vetëm në revistat Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria dhe Zëri i Kosovës, të botuara në vitet 1980-1982.

1-12.Lëvizja Kombëtare e Kosovës LKK

Në periudhën e sundimit të gospodinave komunist-marksist-leninist të Jugosllavisë në tokat shqiptare nuk ka ekzistue për asnjë moment një organizatë konkrete me emrin konkret,

-Lëvizja Kombëtare e Kosovës LKK, emërtimi i së cilës sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes bëhet me germa të mëdha. Ky emër nuk gjendet në asnjë rast të vetëm në revistat Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria dhe Zëri i Kosovës, të botuara në vitet 1980-1982.

1-13.Lëvizja Kombëtare Shqiptare LKSH

Në periudhën e sundimit të gospodinave komunist-marksist-leninist të Jugosllavisë në tokat shqiptare nuk ka ekzistue për asnjë moment një organizatë konkrete me emrin konkret,

-Lëvizja Kombëtare Shqiptare LKSH, emërtimi i së cilës sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes bëhet me germa të mëdha. Ky emër nuk gjendet në asnjë rast të vetëm në revistat Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria dhe Zëri i Kosovës, të botuara në vitet 1980-1982.

1-14.Lëvizja Ilegale LI

Në periudhën e sundimit të gospodinave komunist-marksist-leninist të Jugosllavisë në tokat shqiptare nuk ka ekzistue për asnjë moment një organizatë konkrete me emrin konkret,

- Lëvizja Ilegale LI, emërtimi i së cilës sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes bëhet me germa të mëdha. Ky emër nuk gjendet në asnjë rast të vetëm në revistat Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria dhe Zëri i Kosovës, të botuara në vitet 1980-1982.

1-15.Lëvizja Ideale e Idealistave pa Ideologji LIII

Në periudhën e sundimit të gospodinave komunist-marksist-leninist të Jugosllavisë në tokat shqiptare nuk ka ekzistue për asnjë moment një organizatë konkrete me emrin konkret, as në formën e përvetshme dhe as në atë të përgjithshme,

- Lëvizja Ideale e Idealistave pa Ideologji LIII, emërtimi i së cilës sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes bëhet me germa të mëdha. Ky emër nuk gjendet në asnjë rast të vetëm në revistat Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria dhe Zëri i Kosovës, të botuara në vitet 1980-1982.

Këta terma e këto emërtime janë të futur në përdorim nga marksist-leninistë e aktivistë të ndryshëm pas falimentimit të praktikave të tyre, nga Tërmeti i Berlinit i vitit 1989, futen në qarkullim *si çadër, si strehë e barabartë e të gjithë aktivistëve gjoja të barabartë.*

Pse këta emra të përgjithshëm që sipas rregullave të drejtshkrimit duhet shënuar me germa të vogla, bëhen emra të përvetshëm, përvetësohen dhe shkruhen me germa të mëdha?

Kjo bëhet me të vetmin qëllim që këto organizata nuk mund të jenë kurrsesi **homogjene**, e për të gjithë njësoj – pra të përgjithshme, nëse në to disa nuk e RUAJN rolin **hegjemon**.

Organizatat e lartpërmendura me emra të përvetshëm nuk kanë ekzistua në të kaluarën, nuk ekzistojnë sot, dhe mundësia është tepër tepër e vogël, gati pambarimisht e vogël se do të ekzistojnë-formohen në të ardhmen.

1-16.Shokët e ideve

Në veprimtarinë time si anëtar i Organizatës: Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi dhe si anëtar i LRSHJ-LRSSHJ,

-Idetë e mia të përgjithshme që i kam përmbledhë në libra, janë faktori vendimtar që mi kanë dhënë lidhjet e kontaktet me shumë njerëz;
-Idetë e mia të përgjithshme që i kam përmbledhë në libra, janë faktori vendimtar që mi kanë dhënë ata shokë apo miq deri në atë shkallë sa i kam pasë apo i kam merituar, të cilët me të gjitha energjitë e mija jam munduar të mos i zhgënjej;
-Idetë e mia të përgjithshme që i kam përmbledhë në libra, janë faktori vendimtar që mi kanë dhënë ata gënjeshtar, ata kundërshtar, e armiq që i kam merituar dhe i meritoj tani, të cilët me të gjitha energjitë e mija jam munduar të mos i zhgënjej.
-Për mua vendimtare kanë qenë dhe mbeten shokët e idetë e tyre në koka, dhe nuk kanë pasur e nuk do të kenë përparësi etiketat e emërtimet zyrtare.

Për mua rrezja e veprimit, rrezja e goditjes së ideve është më e rëndësishme, është vendimtare dhe nëse ato ide përmbajnë vlera të vërteta nuk mund të mbyllen brenda kufijve të asnjë organizate e etikete-emërtimi. Duke u nisur nga kjo shpresoj shumë se kështu do të jetë edhe e ardhmja, për aq sa do të ketë të ardhme vepra e ime e shkruar, e bazuar në këto ide, dhe se,

-do të më jap ata lexues, vlerësues, ata të vërtetë, miq e shokë të cilët i meritoj, të cilët nganjëherë mund të vijnë prej një drejtimi që nuk e pret,
-do të më jap ata gënjeshtarë, kundërshtar, e ata armiq të cilët i meritoj,
të cilët nganjëherë mund të vijnë prej një drejtimi që nuk e pret.

"Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh"

Duke u mbështetur rigorozisht në fjalinë e mësipërme nuk mund të bëjmë kurrfarë analize sepse kurrë nuk ka ekzistua një organizatë unike me emrin

-**L**ëvizja ilegale, si emër i përvetshëm e i përvetësuar, por mund të thuhet se ka ekzistue -**l**ëvizja ilegale, si emër i përgjithshëm, e njejtë për të gjithë.

Në lëvizjen e përgjithshme ilegale mund të përfshihen shumë organizata konkrete me emra konkret në formën e përvetshme. Në mesin e tyre mund të përmendim Lëvizjen e Jusuf Gërvallës.

"Një veprimtar i Lëvizjes ilegale mes patriotësh"

Fjalia si e tillë, pa nënkuptime nuk ka diçka konkrete. Me nënkuptime, nëse e zgjerojmë pak në formën "Një veprimtar i barabartë i lëvizjes ilegale mes patriotësh të barabart (në formën juridike dhe jo në bazë të dhuntive psikologjike)", kjo fjali nuk ka të bëjë aspak me të vërtetën. Jusuf Gërvalla nuk është trajtuar juridikisht i barabart nga OMLK-ja. Këtë e dëshmon çdo rresht i veprës së shkruar nga Jusuf Gërvalla.

1-17.VENDI I MADH - VENDI I NDERIT

Me ka ra rasti ta lexoj një mendim se;

-është gabim të thuhet se Lëvizja e Adem Demaçit apo Lëvizja e Metush Krasniqit ka qenë vendi më i përshtatshëm apo i vetmi për veprimtarinë e Jusufit. Pra është gabim të bëhet një kufizim i tillë sepse Jusuf Gërvalla i ka pasur dyert e hapura tek të gjitha organizatat politike e patriotike, dhe të gjitha organizatat do ta kishin pranuar e anëtarësuar dhe do të kishin vendosur në vendin e nderit, në krye të oxhakut, në vendin e madh dhe kështu do ta kishin bërë edhe më të madh se sa ai ka mundur të bëhet brenda Lëvizjes së tij.

Ky është një mendim tepër tepër naiv se në organizata politike të gjithë ia lëshojnë rrugën atij që është më i miri, më i dituri e më mendjendrituri.

Nuk po ndalem në raste të panevojshme, por vetëm tek Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës -OMLK. Komplet udhëheqja e saj nuk kanë pranuar në asnjë mënyrë të jenë në një organizatë të bashkuar me Jusuf Gërvallën.

Pse?

Sepse kanë pasur frikë prej tij, dijes së tij dhe autoritetit të tij. Kanë pasur frikë se po ua rrezikon vendet. Skemat e ndarjet me Pararojë e me Front kanë qenë pikërisht të dizajnuara në formë speciale **vetëm që njerëzit si Jusuf Gërvalla**, të mos i kenë tepër larg, por edhe t'i kenë në distancë të sigurtë prej Organizatës Pararojë.

Pa fijen e dilemës mund të themi se Lëvizja e Adem Demaçit dhe Metush Krasniqit ka qenë vendi më ideal për Jusuf Gërvallën i cili në kohën e vetë e ka udhëhequr në mënyrë të përsosur atë që me të drejt quhet e njihet si Lëvizja e Jusuf Gërvallës.

Në librin *QENDRA Jusuf Gërvalla* e kam sqaruar tërësisht pse aty ku ka qenë Jusufi ka qenë QENDRA.

Këtu po dua t'i shtoj disa fjalë me një ilustrim tjetër.

Me një personalitet të njohur dhe shumë të rëndësishëm ndodhë kjo ngjarje:

Me rastin e një tubimi, solemniteti apo manifestimi, personaliteti kur mbërrinë te hyrja e sallës, organizatorët me shqetësim të madh i thonë;

> -Na ka ndodhë një e papritur dhe një problem i madh. Kanë ardhë para disa çastesh disa njerëz të paturpshëm dhe janë ulë në vend të madh, në vend të nderit. Si t'ia bëjmë?
>
> -Asgjë mos bëni, leni aty ku janë. Aty ku ulem unë është Vendi i Madh. Aty ku ulem unë është Vendi i Nderit.

Jusuf Gërvalla kurrë nuk është mërzit për vend të madh e për vend të nderit sepse aty ku është ulur ai ka qenë vendi i madh dhe vendi i nderit.

Atë të madh e ka bërë puna e tij dhe forcat e natyrës.

Jusuf Gërvalla kurrë nuk është bërë e nuk është i madh pse ka ndejtë e është shoqërua me njerëz të mëdhenj, por vetëm e vetëm për shkakun se njerëzit e vegjël, e hiçat prej hiçi i ka bërë të mëdhenj.

1-18.Marksistët me ide në kokë dhe marksistët me knizhica në xhep

Në disa raste kam lexuar apo dëgjuar deklaratën se

> -Jusuf Gërvalla (pos tjerash) ka qenë marksist-leninist!

Ka dëgjues të painformuar por edhe të paprovuar me probleme të komplikuara politike të cilët menjëherë kalojnë tek konkluzioni apo pyetja vijuese:

> -Në cilën Organizatë marksiste-leniniste ka qenë anëtarë? apo
>
> -Në cilën parti komuniste marksiste-leniniste ka qenë anëtarë?

Nga parashtrimi i mësipërm fitohet përshtypja se është e pamundur me pasë ide komuniste në kokë pa e pasur një knizhicë në xhep të ndonjë Organizate të quajtur Organizatë Marksiste-Leniniste apo Parti Komuniste Marksiste-Leniniste.

Prej nga mund të vijmë me diskutim deri në atë pikë; se krejtësisht vendimtare është knizhica në xhep dhe jo idetë në kokë.

Deklarimi në pikën; ka qenë marksist-leninist mendoj se e don një sqarim.

1. Të kesh ide marksiste-leniniste në përgjithësi është një çështje më vete dhe
2. T'i takosh një organizate të quajtur Organizatë apo Parti komuniste me emër konkret-të përvetshëm, është çështje krejtësisht tjetër.

Jusuf Gërvalla: "*Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi,* ***ne*** *– një pjesë e pararojës patriotike e* ***komuniste*** *të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të* ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi*** *– dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 2)

Fjalët e mësipërme nga Jusuf Gërvalla, të lexuara dhe të aprovuara prej meje, para se të shtypen-publikohen, vlejnë të paktën për Jusufin dhe mua.

Pra, Jusuf Gërvalla dhe unë kemi qenë;

-komunistë në gji të ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi***, e cila nuk ka qenë as Organizatë e as Parti komuniste.

Në përpilimin formulimin e fjalëve të mësipërme me e quajt veten si persona komunist në bazë të mendimeve e bindjeve në kokë, nuk i kemi marrë leje askujt. Idetë e bindjet politike nuk janë monopol dhe as TradeMark **TM** e askujt.

Nga e tërë kjo rrjedhë dhe është me rëndësi të potencohet se:

-Jusuf Gërvalla e unë nuk kemi qenë komunistë të knizhicave, do me thënë nuk kemi qenë as anëtarë, as celulë e as masha të ndonjë Organizate Marksiste-Leniniste apo Partie Komuniste Marksiste Leniniste që ka vepruar për çështjen e shqiptarëve nën Jugosllavi, të cilat kanë pasur ide konfuze e të çoroditura.

Ne, në gji të ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi***, kemi pasur ide komuniste, simpati për idetë e vërteta komuniste, për socializmin e vërtetë e për lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Të gjitha këto qëndrime mund të kontrollohen lehtë në shkrimet e Jusuf Gërvallës dhe të miat.

Jusuf Gërvalla: "*Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi,* ***ne – një pjesë e pararojës patriotike*** *e* ***komuniste*** *të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi – dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 2)

Nga fjalët e mëposhtme:

ne – një pjesë e pararojës patriotike *e* ***komuniste***

Jusufi i mendon dy lloje pararojash,

-**pararojën patriotike** dhe

-pararojën komuniste.

Që të dy pararojat sa i përket LNÇKVSHJ konsiderohen si pjesë.

Çka do të thotë kjo?

Që të dyja konsiderohen

-pjesë, do me thënë jo komplete, pra që nuk kompletohen vetëm nga LNÇKVSHJ,

-dy pararoja të bashkuara – të hapura për të gjithë personat me ide e ideale.

Të tjerët këto gjëra për kushtet e Kosovës, në kohën e luftës për liri kombëtare, i kanë konsideruar

-të ndara
-duke i vendosur etiketimet komuniste e marksiste-leniniste në plan të parë, **jo nga bindja por me të vetmin qëllim** që t'i japin vetes të drejtë t'i dominojnë të tjerët,
-të mbyllura, do me thënë
-komplete për llogaritë e tyre.

Pasi këto çështje i kam analizuar në hollësi në librat e mëparshëm nuk është e domosdoshme dhe as e nevojshme të zgjerohem këtu.

***

Problematika e përkatësisë në bashkësitë e ndryshme të organizuara ideologjike duke përfshi edhe ato fetare dhe raporti e lufta për të pasur mendime e ide personale e për të ekzistuar si njeri i lirë, është aq e gjer sa në hollësi nuk është e mundur të shqyrtohet këtu dhe nuk është qëllimi im ti marrë këto tema në shqyrtim.

2.Koha

Kuptimi i kohës së Jusuf Gërvallës dhe Lëvizjes së tij bëhet më i lehtë nëse kthehemi prapa në kohë deri tek vetë zanafilla e origjina e kohës.

Big Bang

Tri vija të dëshmive vrojtuese mbështetin teorinë e big bang:
-zgjerimi i universit (the universal expansion),
-zbulimi i gjithë pranishëm i *Cosmic microwave background*
-raporti (përqindja) e elementeve të lehta hidrogjenit dhe heliumit.

Historia epike e evolucionit dhe zhvillimit të planetit të Tokës është një rrugë që ka filluar para rreth 14 miliard vitesh, me formimin e atomeve dhe molekulave pak kohë pas big bang. Këto lëndë të para do të bëhen tullat-pjesët-blloqet ndërtuese të yjeve, të cilëve u ka ardhë radha t'i krijojnë të gjitha elementet që do ta formojnë Tokën dhe planetet tjera shkëmbore.

Origjina e Sistemit tonë Diellor ka filluar para 4,567 miliardë vitesh.

2-1.Koha fizike, koha biologjike dhe koha psikologjike

Filozofi Shën Augustini, lidhur me definimin e kohës ka thënë:

"Çka është koha?

Nëse askush nuk më pyet mua, e dij. Por nëse dikush më pyet dhe kërkon t'ia shpjegoj se çka është, nuk e di."

Në literaturë shkencore ndeshet kategorizimi:
-Koha fizike - koha publike që matet me orë,
-Koha biologjike - të rrahurat e zemrës, ritmi i frymëmarrjes dhe procesi moshimit në përgjithësi,
-Koha psikologjike – koha private, koha subjektive; dikush thotë s'po më kalon koha, e tjetri mund të thotë se po më kalon koha shumë shpejt.

Në Teorinë e Relativitetit të Einsteinit, koha është një dimension krahas tri dimensioneve të hapësirës: gjatësisë, gjerësisë dhe lartësisë, që në diagramet e shkencës qëndrojnë në pozitë perpendikulare (90 shkallë ndaj njëra tjetrës) ndërsa koha qëndron në pozitë perpendikulare me të tri dimensionet e hapësirës.

Për të lehtësuar shqyrtimin në *SPACETIME diagrame* kemi dy vija perpendikulare me njëra tjetrën. Tri vijat e hapësirës thjeshtohen në një, në boshtin horizontal dhe koha në boshtin vertikal. Këto diagrame gjenden në literaturë shkencore dhe unë nuk i kam përdorë këtu.

2-2.Matja e kohës



Përcaktimi i periudhave kohore me metoda radiometrike, p.sh. përmes izotopeve të Uraniumit 238 (në disa miliarda vite) apo karbonit C14 (në disa mija vite)

Matja e kohës përmes rrotullimit të hënës - prejardhja e muajve është përdorur sidomos në kalendarët fetar.

Rrotullimi i tokës rreth boshtit të vetë-ditët.

Numri i oscilimeve, të vibracioneve në kristalet e kuarcit,

Orët atomike, frekuenca rezonante-resonansfrekvens p.sh. tek Cesiumi-mundësojnë funksionimin e sistemit GPS.

Ora atomike me saktësinë më të madhe është në National Physical Laboratory në Britaninë e Madhe që në matje të kohës e bënë një gabim më të vogël se 1 sekondë në 138 000 000 vjet.

Ludwig Eduard Boltzmann (1844-1906), fizikan dhe filozof austriak. Vepra e tij jetësore është në zhvillimin e termodinamikës dhe mekanikës statistikore. E ka dhënë formulën shkencore për entropinë.

Koha për të cilën bëhet fjalë në këtë pjesë përfshinë veçanërisht periudhën dhjetor 1979-janar 1985. Në mënyrë pak më të zgjeruar mund të thuhet se kjo periudhë shtrihet deri në shkurt 2025.

2-3.Dragoi Ketë Avdia dhe Zanat e zanafillës

Mitologjia përpiqet të jap përgjigje në pyetje jo-empirike, përgjigje në të cilat nuk mund të përgjigjemi duke shikuar e observuar.

A ka jetë pas vdekjes?

Si është krijuar universi (para Big Bang)?

A ka zot?

Mitologjia përmban tregime që nuk merren tekstualisht por që japin përgjigje në pyetje bazike rreth universit. Mitet kanë mesazh. Për dallim nga religjioni ngjarjet mitologjike ndodhin krejtësisht në zanafillë dhe janë jashtë kronologjisë apo kohës kalendarike.

(Ai që do të dij më shumë për dragoin Ketë Avdia dhe Zanat e zanafillës mund ta lexoj romanin *Rrotull* të Jusuf Gërvallës).

Në të kundërtën, në religjion, koncepti i besimit (nuk kërkon prova) është themelor. Në religjion përfshihen tregime që besohen se janë historike, p.sh. tregimi i Mojsiut në Bible, që ndodhë në një kohë kronologjike-kalendarike.

Filozofia merret edhe me trajtimin e çështjeve të religjionit, por për dallim nga religjioni filozofia kërkon prova të bazuara në logjikë.

Përgjigjet në pyetjet e mëdha filozofike nuk janë çështje e pikëpamjeve por e fakteve të cilat na janë të panjohura. Kjo nuk do të thotë se pyetjet e mëdha janë relative, por duke u bazuar në perspektivën tonë të kufizuar, nuk kemi përgjigje në to. P.sh. A është universi pa fillim (që ka ekzistuar gjithmonë) apo e ka një fillim prej asgjëje?

2-4.Shkenca

Shkenca – është cilido sistem i diturisë që preokupohet me botën fizike dhe fenomenet e saj, e që bazohet në observime të paanshme dhe eksperimentime sistematike. Në përgjithësi, një shkencë do të thotë hulumtim i diturisë duke përfshi të vërteta të përgjithshme dhe funksionimin e ligjeve fundamentale.

2-5.Artet

Artet, lloje të shprehjes që përdorin mjeshtëri apo imagjinatë në krijimin e objekteve e mjediseve estetike, apo përjetimeve që mund të ndahen me të tjerët.

Kategoritë tradicionale të arteve përfshijnë literaturën (poezi, drama, tregime etj.), artet figurative (pikturë, vizatim, skulpturë etj.), artet grafike (pikturë, dizajn dhe forma tjera të shprehura në sipërfaqe të rrafshëta), artet plastike (skulpturë, modelim), artet dekorative (punë me smalt, dizajn mobiljesh, mozaik etj.) dhe arkitekturë (shpesh duke përfshi edhe dizajnin e brendshëm).

2-6.Shkrimi i historisë është një sintezë në mes shkencës dhe artit

”Vetëm një njeri i madh mund ta shkruaj historinë.” (Oscar Wilde)

Historia është ajo çka ka ndodhë në të kaluarën.

Shkrimi i historisë është një tregim, një prozë humanistike e ngjarjeve në bazë të hulumtimeve sistematike të fjalëve, veprave, ideve, konflikteve dhe vuajtjeve që kanë ndodhë në të kaluarën dhe që kanë lënë gjurmë-dëshmi të verifikueshme deri në kohën prezente.

Me prozë ”humanistike” - mendohet në diçka që u ka ndodhë njerëzve apo në mes njerëzve. Pra nuk mendohet në çështje providencës së Perëndisë, jo pse historia është antireligjioze por për shkakun se materiali dhe metodat e religjionit dallohen prej atyre të historisë.

Çka mendohet me ”prozë narrative”?

Historia nuk është poetikë apo një shfaqje orale.

Qëllimi i historisë është para së gjithash informimi. Fjala histori e ka prejardhjen nga greqishtja që do të thotë ”hulumtim”, ”kërkim”.

Me gjurmë-dëshmi të verifikueshme mendohet në dëshmi që mund të verifikohen edhe nga të tjerët. Shkrimi i historisë ka për qëllim të funksionoj sipas llojit të dëshmive që mund të gjenden në gjykatat e drejtësisë.

”Qëllimi i historisë është të parandaloj harresën e veprave fisnike, dhe të krijoj frikë tek ata që merren me fjalë e vepra djallëzore e kriminale, nga njolla e turpit që i pret në të ardhmen, prej gjykimit të historisë.” (Tacitus)

Jam munduar që vepra ime të jetë sintezë e forcës së argumenteve dhe drejtësisë, pra sintezë e forcës dhe idealeve të drejtësisë, sintezë për të cilën njerëzit;

-kanë luftuar,
-rënë dhe
-fituar

e që për këtë sintezë frymëzohen për të ardhmen.

Nuk kam fabrikua gënjeshtra. Nuk kam fshehur të vërteta. Jam udhëhequr nga dashuria për të paraqitur veprimet fisnike në dritë dhe nuk jam udhëhequr nga inati për askend.

Historia nuk është barrë e memories por ndriçim i shpirtit.

2-7. Klepsidra, Danilo Kiš dhe Jusuf Gërvalla

Klepsidra

Romani "Klepsidra" i Danillo Kishit botohet për herë të parë me emrin e përkthyesit, Jusuf Gërvalla

Romani "Klepsidra" i Danilo Kiš -it, i përkthyer nga shkrimtari, muzikanti, aktivisti dhe atdhetari Jusuf Gërvalla (1945-1982), është botuar për herë të parë në Kosovë më 1977, por pa emër përkthyesi. Ndërkaq, tashmë vjen i botuar nga 'BardBooks' për herë të parë me emrin e përkthyesit, dyzet vjet pas vrasjes së tij nga Shërbimi Sekret Jugosllav, i njohur si UDB, përcjell KultPlus.

Lajmin e ka bërë të ditur shkrimtari i njohur Ag Apolloni i cili në këtë ditë ka përkujtuar Gërvallën. Ndërkaq, libri do të dalë nëpër librari nga fundi i muajit.

Më poshtë gjeni postimin e plotë të Apollonit:

Një roman i përkthyer nga Jusuf Gërvalla, i cili u vra më 17 janar 1982 Romani "Klepsidra" i Danillo Kishit, i përkthyer nga shkrimtari, muzikanti, aktivisti dhe atdhetari Jusuf Gërvalla (1943-1982), është botuar për herë të parë në Kosovë më 1977, por pa emër përkthyesi. Kjo është hera e parë që botohet me emrin e përkthyesit, dyzet vjet pas vrasjes së tij nga Shërbimi Sekret Jugosllav, i njohur si UDB.

Për arsye teknike, libri do të dalë nëpër librari nga fundi i muajit. Falënderoj tre anëtarët e Bard Books për punën e zellshme në përgatitjen e këtij libri: Mirjetë Sadikun, që e ka transkriptuar e korrektuar, Eronita Kqikun që e ka redaktuar, dhe Liridon Zekajn që e ka konceptuar dhe dizajnuar.

Shtëpia botuese Bard Books, gjithashtu ka botuar librin "Mansarda" të Danillo Kishit, dhe do të vazhdojë t'i botojë edhe veprat e tjera të këtij autori jugosllav me prejardhje hebreje, vepra e të cilit është vlerësuar lart nga Milan Kundera, Philip Roth, Susan Sontag etj.

Gjithashtu, për disa sqarime mbi përkthyesin, falënderoj zonjën Suzana Gërvalla.

(KultPlus.com)

Klepsidra: Danilo Kish - Jusuf Gërvalla

2-8.Orët e ndalura përgjithmonë në Shkup dhe Shtutgart

Më 26 qershor 1963 në ora 5.17 të mëngjesit ka ndodhur tërmeti i Shkupit.



Ora e ndalur përgjithmonë në Shkup

Më 17 janar 1982 në Shtutgart ora është ndalur në 22.15

Ora e ndalur përgjithmonë në Shtutgart



Suzana dhe Jusuf Gërvalla

”Tash ti je ora ime e ndalur përgjithmonë”

(Jusuf Gërvalla, Kanjushë e verdhë, Vepra 1, Prishtinë, 2010, faqe 104)

2-9.Shkallët-hapat e kufizuar në matematikë, logjikë dhe juridikë

Vërtetimi i teoremave në matematik e logjik bëhet me një procedurë të kufizuar në disa shkallë-hapa, dhe merr fund.

Në gjykatat e drejtësisë, procesi gjyqësor zhvillohet brenda një kohe të kufizuar dhe dëgjimi e paraqitja e provave merr fund. Kjo do të thotë se si në matematik, logjik e juridik kemi procese që mbyllen dhe nuk ka hapësirë për lojëra se cili po bënë zhurmë më shumë e po çon pluhur më shumë.

2-10.Tri këshillat e policisë amerikane

Kur policia amerikane arreston dikend për shkak të dyshimit se ka bërë apo është përzier në veprimtari kriminale ia jep këto tri këshilla-tri fjali të renditura si më poshtë:

-*You have the right to remain silent.*
-*Anything you say could be used against you in a court of law.*
-*You have the right to contact a lawyer.*
-Ke drejt me heshtë.
-Çdo fjalë e jotja mund të përdoret kundër teje në gjykatë të drejtësisë.
-Ke të drejtë të kontaktosh avokat.

2-11.Forca e fjalës së parë, fishkëllimës së parë dhe kokorizja e fundit

Në pikëpamje kohore, në rrethana të ndryshme, e tubime të ndryshme ka rregullore e rende dite se kush e merr fjalën në fillim, kush në mes e kush në fund.

Në jetë ndeshemi me provokator që kërkojnë që rregullat janë të mira kur vlejnë për të tjerët por jo edhe për te.

Ideja e provokatorëve është se ata i bien fyellit, ata e krijojnë muzikën dhe ti duhet me vallëzua sipas notave të tyre.

Provokatorët mendojnë se ata, në çdo kohë duhet me e caktuar rendin e ditës dhe ata vendosin se cilat tema duhet diskutuar e cilat jo, cilat pyetje duhet të marrin përgjigje e për cilat duhet të heshtet. Një ilustrim i skemave të tyre gjendet më së miri në botën shtazore.

Është zbulim i studiuesve se qurat reagojnë ndaj zërave e fishkëllimave. Pra pa marrë parasysh se sa herë u fishkëllon qurave, ato gjithmonë përderisa t'u qëndroj zëri përgjigjen, kokorizen, e thonë fjalën e fundit.

2-12.Historia e Kosovës, e popullit shqiptar nuk mund të shkruhet pa Jusuf Gërvallën!

Historia e Kosovës, e popullit shqiptar nuk mund të shkruhet pa XY!

Shprehjet e lartpërmendura më ka rënë t'i lexoj kohë pas kohe për persona të ndryshëm dhe për Jusuf Gërvallën. Mendoj se ia vlen me u ndalë pak në këto shprehje me vëmendje.

Autorët e deklarimeve të tilla duket sikur kanë apo i nënkuptojnë dy baza themelore mbi të cilat i ndërtojnë idetë e tyre:

-Ekziston një Institucion, një rreth i **<u>mbyllur</u>** historianësh të lidhur me Institut të Historisë, apo një Akademi që e ka të drejtën ekskluzive ta shkruaj historinë e XY apo të Jusuf Gërvallës, apo të kujdoqoftë që e meriton.

-Ekziston Libri i historisë së Kosovës apo Arbërisë, me një numër të caktuar, të kufizuar, **të mbyllur**, të faqeve brenda kopertinave të të cilit Instituti i Historisë apo Akedemia e ka për detyrë me ia bërë një vend, në një faqe apo pjesë faqeje të kësaj Historie, atij që e meriton, në këtë rast Jusuf Gërvallës.

Kjo mënyrë e vështrimit të ngjarjeve duket sikur e ka burimin në dy komponente:
-Traditën e Instituteve të vendeve me kulturë të zhvilluar në përgjithësi dhe
-Monopolin e censurës dhe të shkrimit, fabrikimit dhe makinerisë falsifikuese të historisë nga Institute me origjinë në Bashkimin Sovjetik, pas vdekjes së Leninit, e që është shpërnda si një sëmundje në vendet e Evropës lindore dhe RPS e Shqipërisë dhe me këtë deri tek imagjinata e disa personave të ditëve tona në Kosovë e Arbëri.

Trajtimi i kësaj teme na sjellë tek një problematikë (apo zgjidhjet që janë bërë), më e gjerë që ekziston në të gjitha vendet e zhvilluara e demokratike, e ajo është:

-çështja e ushtrimit të profesioneve që rregullohen me ligj, të legjitimuara,
-çështja e ushtrimit të profesioneve që nuk rregullohen me ligj, - të lira.

Profesionet kryesore të rregulluara me ligj dhe tituj të mbrojtur me ligj janë ai i mjekut dhe avokatit. Pra nuk mundet çdo kush me e quajt veten mjek apo avokat pa e pasur kualifikimin e duhur shkollor dhe disa kushte etike e morale që kërkohen sidomos nga këto profesione. Përjashtimi prej Shoqatës së mjekëve apo avokatëve në praktikë do të thotë humbje e të drejtës për ta ushtruar atë profesion edhe nëse ke kualifikim formal shkollor.

Në këtë drejtim është interesant ta shikojmë se si qëndron puna me oficerët dhe gradat ushtarake. Oficerët e shkolluar nga shteti i kanë titujt e mbrojtur nga shteti dhe ato grada u njihen edhe nga shtete tjera, edhe nëse janë ndërluftuese.

Por lufta para së gjithash është ART.

Në furtunat e historisë e të lëvizjeve e tërmeteve të mëdha, gradat ushtarake të Akademive ushtarake nuk të garantojnë sukses.

Edhe pse në kohën e lëvizjeve dhe tërmeteve të mëdha sociale vetë kori i oficerëve dhe ushtria përçahet dhe marrin anë të kundërta në konflikt-luftë, rasti i dy gazetarëve; Leninit dhe Trockit, - që asnjë ditë nuk kanë qenë në ndonjë Akademi ushtarake por që kanë fituar mbi shumë gjeneral e mija oficer të Akademive të Carit dhe shteteve intervenuese tregon se duhet të kemi kujdes në këto çështje.

Për dallim nga rastet e mësipërme profesioni i poetit, shkrimtarit, piktorit e shumë e shumë profesione të ngjashme janë të lira, të hapura për çdo kend që edukimi apo vetedukimi dhe natyra u kanë dhënë dhuntinë. Nëse një shkollë e mesme shpall konkurs për punësimin e një profesori të historisë, në këtë rast kërkohet kualifikimi shkollor e akademik dhe vetëm ai që i plotëson kushtet e kërkuara mund të kërkoj punë. Në këtë kuptim mund të thuhet se profesioni i historianit është i mbrojtur me ligj. Por në ngjashmëri me ato që u thanë më lart profesioni i historianit nuk është profesion i mbrojtur me ligj – sa i përket pjesës së shkrimit të veprave historike. Ka shumë e shumë persona që kanë studiuar letërsi e gazetari dhe që shkruajnë libra të mirë historik dhe e quajnë veten historian, që në studiot televizive prezantohen si historian. Ka shumë e shumë persona që kanë studiuar historinë me qëllimin kryesor që ta kenë një vend pune në sistemin arsimor dhe nuk merren me shkrimin e librave historik.

Kuptohet se mund të ketë dhe ka në të gjitha vendet, të zhvilluara e më pak të zhvilluara, fërkime, xhelozi e angazhime për me i trembë të paftuarit prej livadhit të vetë por kjo punë është sa qesharake aq edhe e kotë, sepse në vende demokratike ligji nuk përzihet në këto punë dhe nuk merr masa ndaj asnjë personi pse dikush mund ta quaj veten historian duke u bazuar në librat e tij historik pa e pasur të përfunduar fakultetin e historisë e pa qenë anëtar në klubin e Institutit të historisë.

2-13.Kardinali Richelieu, Samuel Johnson dhe James Murray

Në fillim të viteve 1500 në kohën kur Leonardo Da Vinci me veprën e vetë Mona Liza është vendosur në Francë, Franca i ka pasur rreth **20 milion banorë**.

Në të njejtën periudhë popullsia e Anglisë ka qenë rreth 4 milionë banorë

Kardinali Richelieu (1585-1642) më 1635 e ka themeluar Akademinë Franceze (Académie française). Ambicia e tij ka qenë që gjuha frenge ta zëvendësoj latinishten si gjuhë të përgjithshme të botës së civilizuar. Detyra e Akademisë ka qenë që në mënyrë sa më të përpikt të vendosë për formën gjuhësore dhe t'i jap bazat për retorikë dhe poetik.

Rreth vitit 1635 Franca i ka pasur 19 milion banorë.

Rreth vitit 1635 Anglia i ka pasur diçka më shumë se 5 milion banorë.

Alexandre Dumas në romanin "*Les Trois Mousquetaires*" e ka Kardinalin Richelieu si një prej personazheve kryesore. Në parathënien (artistike) të romanit të lartpërmendur, A. Dumas flet për përvojën e mirë që e ka me *Académie française*, e cila e vlerëson romanin.

Ashtu siç ka kujtime të bukura Alexandre Dumas me *Académie française*, edhe krejt populli shqiptar ka kujtime edhe më të bukura rreth A. Dumas, pasi ai në librin *"Le Comte de Monte-Cristo",* një prej kryeveprave të letërsisë botërore, krahas personazhit kryesor në qendër të vëmendjes e ka Ali Pashë Tepelenën dhe familjen e tij.

Samuel Johnson – Dr. Johnson 1709-1784

Samuel Johnson, i njohur si Dr. Johnson, më 1755 e boton fjalorin "*A Dictionary of the English Language*" fjalorin më të rëndësishëm të Anglisë e anglishtes për më shumë se një shekull.

Pra kemi të bëjmë me veprën e një personi, individi prapa të cilit nuk qëndron asnjë institucion shkencor-shtetëror.

Si vazhdimësi e veprës-punës individuale të Samuel Johnson-it, mund të konsiderohet vepra e një kolektivi të udhëhequr, për tridhjetë vite, nga James Murray.

James Murray (1837-1915)

Kryeredaktor i Oxford English Dictionary, James Augustus Henry Murray ka lindur si bir i një rrobaqepësi në Denholm, Skotland. Është shkolluar në lokalitetin e lindjes deri në moshën 14 vjeçare. Prej moshës së re ka treguar afinitet për gjuhësi, dhe ia ka arritë t'i mësoj rreth 25 gjuhë të ndryshme.

Përveç interesit të vazhdueshëm për gjuhësi, ka vetëstudiuar fusha të ndryshme të shkencës si botanik, gjeologji dhe astronomi dhe ka qenë themelues i Archaeological Society në moshën 19 vjeçare.

Më 1878 është emëruar Kryetar i Philological Society dhe janë zhvilluar bisedime me Oxford University Press për ta marrë përsipër redaktimin e Shoqatës së Filologëve (me seli në Londër), New English Dictionary. Përkundër mosmarrëveshjeve fillestare në mes Murray dhe Oxford University Press, lidhur me skicën e vijave-kritereve kryesore të punës redaktuese, Murray pajtohet dhe ia fillon punës së tij më 1879, fillimisht krahas punës së tij si mësues dhe prej vitit 1885 me orar të plotë në shtëpinë-banimin e tij të ri në Oxford.

Gjatë tridhjetë viteve në Oxford, Murray tërësisht iu ka përkushtua punës në fjalor dhe kontributi i tij ka qenë i jashtëzakonshëm. Ai e ka përcaktua standardin dhe modelin origjinal për punë dhe personalisht e ka redaktuar gjysmën e botimit të parë. Më 1908 për përpjekjet e tij i është dhënë titulli i kalorësiak- Sir. Ai nuk ka arritë të jetoj dhe ta shoh botimin e parë të kompletuar, dhe ka vdekur nga pleurit-i më 1915, por arritjet e tij të mahnitshme u kanë dhënë gjeneratave të redaktorëve të ardhshëm një bazë solide mbi të cilët ata prej asaj kohe kanë vazhduar ndërtimin, përsosjen e fjalorit OED.

Në vitin 1933 *The Oxford English Dictionary është botuar në 12 vëllime.*



The Oxford English Dictionary, OED, Oxford University Press, botimi 2, 1989

Botimi i dytë është bërë më 1989, që përmban 21728 faqe, në 20 vëllime.

Këtë fjalor në 20 vëllime, e posedoj nga viti 1995 dhe e kam përdorë, krahas fjalorit të shqipes, gjatë shkrimit të historisë së Lëvizjes së Jusuf Gërvallës.

Më këta shembuj nuk kam qëllimin më të vogël të nënvlerësoj institucione. Por mbetet fakt i pamohueshëm se Institucionet nuk të garantojnë çdo herë sukses, dhe kurrë nuk të garanton sukses keqpërdorimi e korruptimi i institucioneve.

Për dallim nga Franca dhe shumë shtete tjera, Anglia apo Britania e Madhe nuk kanë Akademi për çështje të gjuhësisë. Nuk e kam ndërmend të them se kush e ka mirë e kush më pak mirë, pasi këto gjëra janë shumë të komplikuara. Mjafton që këto gjëra t'i vërejmë dhe konstatojmë si fakte.

Në vendet e zhvilluara, demokratike dhe me tradita e kontribute të mëdha në fushën e kulturës nuk ka Akademi që ka monopol mbi shkrimin e historisë së një populli.

Historia e një populli, të vogël apo të madh, është tepër komplekse, tepër e larmishme dhe e pasur. Ajo nuk mund të futet brenda kopertinave të çfarëdo institucioni qoftë, edhe sikur pikënisja të jetë prej qëllimeve më të mira.

Në botën e industrisë moderne mund të marrim dy shembuj, dy ndërmarrje: Microsoft dhe Apple. Që të dyja janë themeluar nga individ që zbulimet kryesore dhe themelimin e ndërmarrjeve e kanë bërë si individ, e është çështje më vete se mendjet më të ndritura të universiteteve aspirojnë për një punë me përgjegjësi në Microsoft dhe Apple.

2-14.Rëndësia e të stazhit-kohës së punës

Në shtete të ndryshme ka rregulla të përafërta të pensionimit që bazohen në stazhin e punës, e stazhi i punës në rastin më të mirë e ndjek orën biologjike të jetës së njeriut. Pra kemi të bëjmë me një kohë të dukshme, punë të dukshme, që njeriu çdo ditë pune është në vendin e punës.

Por ka raste e sfera të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, ku kemi një ndarje, një punë e përgatitje të madhe, individuale, të padukshme dhe një pjesë më të vogël dhe të dukshme.

Në gara sportive kjo është më së lehti të vërehet. Një sportist mund të ushtroj, i vetmuar, me vite të tëra, me 10 e 15 vjet, por pjesëmarrja në garë apo Olimpiadë, para publikut e lufta për medalje mund të kryhet brenda disa minutash, apo edhe brenda disa sekondash.

Një atlet i përgatitur me vite e i përsosur nuk ka nevojë, nuk e ka për obligim të turpërohet për suksesin e tij, nuk ka nevojë t'u kërkoj falje atyre me rezultate më të dobëta apo t'u kërkoj falje atyre që as nuk janë kualifikuar për të marrë pjesë në gara.

Situatë të ngjashme mund të kemi edhe në shkencat e natyrës, apo në letërsi. Shkencëtari mund të kaloj me dekada në laborator deri sa ta bëjë një zbulim me rëndësi dhe të merr mirënjohje nga nivele të ndryshme të shoqërisë. Shkrimtari mundet të kaloj me vite, i vetmuar duke shkruar një libër, e publikimi është një procedurë me e shkurtë.

Tek rasti i Jusuf Gërvallës, krahas veprimtarisë së tij shumë të dukshme kulturore, paralelisht kemi një përgatitje të gjatë, të qetë, në dukje të heshtur e të vetmuar, për punën e tij të madhe, të pakrahasueshme, që e bënë gjatë dy viteve në Gjermani.

2-15.Me ngut - me alarm

Jusuf Gërvalla: "*Tashmë dihet se në krye të frontit për çlirimin social e nacional të shqiptarëve nga Jugosllavia borgjezo-revizioniste dhe për bashkim me vendin amë Shqipërinë Socialiste, po depërtojnë disa nga forcat më përparimtare të intelektualëve shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Por, dihet gjithashtu se një pjesë e madhe e intelektualëve tanë përkunden në gjumin e "ëmbël" të oportunizmit, të konformizmit dhe "izmave" të tjera, që e ngadalësojnë me të madhe realizimin e çështjes sonë të madhe. Seriozitetin historik kombëtar këta intelektual e marrin si çështje së cilës mund t'i kushtohemi nga çasti dhe si çështje që gjithmonë tjetërkujt i përket më shumë se atyre. Ata vazhdimisht presin një ´kohë të përshtatshme´ dhe ´një njeri të denjë´ që t´i thërrasë e t´i bashkoj në luftën e pashmangshme për çlirimin e tokave tona të zaptuara e kështu për realizimin e aspiratave shekullore të shqiptarëve, dhe vazhdimisht harrojnë se pikërisht nga radhët e tyre mund të dalë njeriu, të cilit do t´i shkoj përdoresh "ta mbledhë e ta sistemoj rebelimin e shpërndarë të shqiptarëve". Jo dyzet vjet thotë një shkrimtar yni, - por as dyzet ditë harresë nuk t´i falte Shqipëria (...) Jo çdo lloj dashurie i hynte në sy Shqipërisë. Dashurinë ajo e donte të veçantë, atë lloj dashurie kur harrohet vetvetja, me dhembje, **me ngut, me alarm**."* (Bashkimi, prill 1980, faqe 2)

Jusuf Gërvalla: "*Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike e revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e "politikës së madhe", lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementësh të dyshimtë e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit, i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtrohet mbi bijat dhe bijtë e Kosovës, na obligon që Atdheut tonë t´i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë Kadareja, - **me ngut, me alarm**, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."*

(Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 2)

2-16.MADHËSIA E PJESËS DHE MADHËSIA E SË TËRËS

Georg Ferdinand Ludwig Philipp Cantor, i lindur më 3 mars 1845 në St Petersburg, Rusi-ka vdekur më 6 janar 1918 në Halle an der Saale, Mbretëria Sachsen, Perandoria Gjermane, ka qenë një matematikan gjerman.

Në matematikën logjike Cantori është i pari që e ka zhvilluar teorinë e bashkësive të pakufishme.

Në fushën e teorisë së bashkësive (set theory) ka vërtetuar se:

-bashkësia e numrave natyral (0, 1, 2, 3,…∞) është pakufishmëri e llogaritshme,

-bashkësia e numrave iracional p.sh. në mes (0-1) është pakufishmëri e pallogaritshme.

Në anglisht quhet ”Cantor's diagonal argument”.

***

Po që se kalojmë nga matematika, që buron nga ligjet e arsyes, racionalizmit, tek vepra tjera të mendjes njerëzore, dhe tek vepra e Jusuf Gërvallës, unë jam marrë vetëm me atë pakufishmëri që e kam parë tek ai në Shtutgart. Unë kam shkruar vetëm për pjesën e Shtutgartit, dhe me këtë shpresoj se kjo punë kontribuon si nxitje, dhe rritjen e interesimit edhe për punën e tij, e frymëzimin e pakufishëm në Prishtinë.

Fakti se nuk kam shkruar për jetën e Jusufit në Kosovë, ku ai e ka kaluar 94% të jetës së tij nuk më ka penguar të shkruaj, sa i përket drejtimit tim, në mënyrë gati të kompletuar për 6% të jetës së tij në Gjermani.

Natyra ka fshehtësi të pakufishme për shkencën. Shqisat tona dhe instrumentet e shkencës, deri më tani arrijnë të njohin në shkallë të ndryshme vetëm 5% të materies në Univers. **Dark matter** dhe **Dark energy** së bashku e përbëjnë pjesën tjetër prej 95%.

Shtetet e zhvilluara investojnë me miliarda e miliarda dollar apo valuta të veta për avancimin e shkencës, dhe askush nuk thotë se duhet ta mësojmë vërtetën për të gjitha, përnjëherë, 100%, pra:

-ja krejt,
-ja hiq.

Cikli i veprave të mija ka të bëjë kryesisht me atë që përkufizohet si Lëvizja e Jusuf Gërvallës, ku Jusuf Gërvalla është figurë qendrore. Kjo ka ndodhë kështu pasi kjo pjesë për mua ka qenë e njohur në hollësi. Puna ime duhet parë si pjesë plotësuese e historisë së përgjithshme të LRBSHJ, e LNÇKVSHJ-së, e LRSSHJ-së.

Unë do të isha i kënaqur që me këtë punë të identifikohet edhe vepra e shokëve e rrethit të Adem Demaçit dhe Metush Krasniqit. Por kjo qëndrimarrje ju takon të tjerëve dhe jo mua.

Ashtu sikurse e njoh veprën e Jusufit vetëm në 6%-shin e fundit të jetës së tij, kjo vlen edhe për edhe për veprimtarinë e Lëvizjes në Kosovë në përgjithësi.

Shprehja: Një punë e lënë përgjysmë është më keq se hiqi nuk vlen për punën time dhe për veprën time rreth Jusufit si luftëtar i lirisë.

-Puna ime është e plotë,

-Vepra e Jusufit për aq sa ka qenë në dorën time është e plotë, por jo krejtësisht e kompletuar.

Në veprat e përmbledhura deri më tani, të Marksit e Engelsit ka vetëm shkrime e letra të Marksit dhe Engelsit dhe jo të të tjerëve. Historia e lëvizjes punëtore ndërkombëtare nuk mund të quhet e plotë vetëm me veprat Marksit e Engelsit, dhe këtë asnjë njeri i arsyeshëm nuk e pretendon. Por kjo nuk do të thotë se në pritje të kompletimit të historisë së lëvizjes punëtore ndërkombëtare (punë që nuk përfundon kurrë pasi këtu kemi të bëjmë me një rrymë e me një proces të pandalshëm e që është në zhvillim tërë kohën), duhet të presim me historinë e Marksit dhe të Engelsit. Vepra e Marksit dhe Engelsit përbënë vetëm **një pjesë** të lëvizjes punëtore ndërkombëtare, por si vepra vetëm të Marksit dhe Engelsit ato përbëjnë **një të tërë**, komplete.

-Lëvizja punëtore ndërkombëtare dhe

-jeta dhe vepra e Marksit dhe Engelsit janë dy gjëra, dy definicione të ndryshme.

Për to mund shkruhet në formë sinteze duke marrë në konsiderim aspekte të ndryshme në shqyrtim, dhe në formë të ndarë, mvarësisht prej qëllimit të studiuesve.

Shefik Sadiku

Shefik Sadiku: ”*Metush Krasniqi ishte përpjekur, me tërë qenien e tij, që energjitë atdhedashëse të të gjithë veprimtarëve, pa dallim ideje, t’i shkrijë në dobi të çështjes kombëtare, për Shqipërinë.*

Se puna e tij ishte në frymën e bashkimit kombëtar, e paraqes një fakt konkret: Metushi organizoi një pritje të ngrohtë në shtëpinë e vet, në Dajkoc të Dardanës, më 2, 3 dhe 4 shtator të vitit 1974, bashkë me Adem Demaçin, Mulla Ramë Govorin, Hyrije Hanën, Ahmet Haxhiun, Selman Ramadanin, Fehmi Bajramin, Sylë Krasniqin (pleqnar), Hazir Krasniqin (kushëri). Në këtë takim ishin edhe Ilmi Ramadani, student, si dhe Emin e Besnik Krasniqi, nxënës.

Nga këto biseda me ndjenja të larta atdhedashurie u arrit marrëveshja e pajtimit në ide e veprime dhe u vendos që të vazhdohet lufta nacionalçlirimtare e Kosovës e viseve tjera në ish-Jugosllavi vetëm me një “Platformë Politike Kombëtare”, as në të majtë e as të djathtë, nga i cili takim, në vitin 1974, do të lind ”Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës” dhe, më vonë, LNÇKVSHJ-ja e viteve 1976/77.” (Me rastin e shënimit të 35 vjetorit të Heroit, Metush Krasniqi, kjo kumtesa u lexua ne Tryezën e mbajtur më 15.10.2021 në Prishtinë. E organizuar nga Këshilli Organizativ “Pranvera Shqiptare ’81”!)

***

Në vitin 1992, kur e kam shkruar punimin ” Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985” nuk e kam pasur të njohur tekstin e Shefik Sadikut si më lartë. Përveç kësaj unë kam reaguar ashpër atëherë dhe reagoj tani kur dikush mundohet me e paraqitë Jusufin bisht të Metush Krasniqit e jo shok të barabartë apo edhe ideolog, ideator e udhëheqës të Metush Krasniqit, me fakte, me gazetë e jo me thashetheme. Fjalët e mësipërme të Shefik Sadikut që janë identike me disa mendime të Selatin Novosellës, nuk i kundërshtoj, dhe i kam cituar,

vendosur edhe në një libër tjetër. E njejta vlen edhe për mendimet e mia për Shefqet Jasharin-Strofcin e Adem Demën-Demaçin.

Lidhur me Adem Demën-Demaçin, e di çka ka thënë Jusufi për Ademin, edhe me shkrim, dhe të po asaj rëndësie janë fjalët e vetë Ademit për Jusufin. Prandaj për periudhën 1979-1982, sa i përket Lëvizjes kjo fotografi si më poshtë, më duket se përputhet më së shumti me realitetin dhe e ilustron ate:

Adem Demaçi **Jusuf Gërvalla** **Metush Krasniqi**

Adem Dema-*Demaçi:* ***"Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."***

Xhafer Durmishi: "*Është meritë e Sabri Novosellës që e organizoi Jusuf Gërvallën në Lëvizje, i cili i vuri aftësitë e tija fizike, mendore dhe intelektuale në shërbim të atdheut, në mënyrë të organizuar."*

2-17.Kuptimi i ngjarjeve dhe kuptimi i kohëve

Në shekullin e kaluar dhe tani dihet mirë se kush ka qenë Karl Marksi. Në kohën e vetë nuk ka qenë shumë i njohur, me përjashtim të rretheve socialdemokrate dhe agjentëve të policive sekrete që e kanë përcjellë. Vetëm me punën e penës së tij ai dhe familja nuk kishin mund me mbijetua. Ndihma e Engelsit ka qenë vendimtare.

Si rrjedhim është gabim tepër i madh me mendua se popullaritetin e sotëm e ka pasur edhe sa ka qenë gjallë.

Në këtë drejtim edhe më interesante është jeta e Leninit.

Kokat tepër naive mund të mendojnë se pse Rusia e Carit nuk e ka vra Leninin "me kohë" e kështu do t'i kishte evituar ngjarjet e vitit 1917 e më vonë.

Vëllau i madh i Leninit, Aleksandri (Sashja) ka marrë pjesë në përgatitjen e një atentati mbi Carin Aleksandin III, më 1887. Atentati ka dështuar, dhe vëllau i Leninit është ekzekutuar.

Lenini më vonë e ka zhvilluar atë veprimtari e cila për të interesuarit është tërësisht e njohur.

Policia e ka njohur mirë Leninin, por edhe babain e tij për punë shembullore, për çka është iu është dhënë një titull aristokratik. Për veprimtari politike Lenini është dënuar të qëndroj në Siberi. Nana e tij, pas vdekjes së burrit e ka pasur një pension shumë të mirë dhe përmes postës

cariste i ka dërguar të holla e e ka mbajtur ekonomikisht birin e vetë. Edhe kur Lenini ka jetua në Evropën Perëndimore, ndihma e ekonomike prej nënës së tij ka qenë me rëndësi.

Policia Cariste e ka përcjellë punën e tij nga afër.

Prej vitit 1911, Roman Malinovskij, një agjent e policisë cariste, me udhëzime të policisë e ka përkrah Leninin dhe kundërshtarët e Leninit i ka lajmërua në polici, dhe policia carsite i ka arrestua sepse i kanë bërë pengesa Leninit. Shkaku i kësaj sjelljeje nga ana e policisë cariste është se ata Leninin e kanë konsideruar personin më të parrezikshëm, person që e përçan socialdemokracinë, dhe si rrjedhim i kësaj personin më të dobishëm nga këndvështrimi i policisë.

Epilogu i gjithë kësaj pjese është se policia edhe pse me resurse shtetërore nuk ka mundur t'i analizoj ngjarjet. Pra ata nuk kishin ngurruar me marrë çfarëdo mase, por nuk kanë marrë masa sepse nuk e kanë njohur në themel, nuk e kanë ditur çka iu del.

Faridin Tafallari: "*Skender, sikur ta kishin njohur punën tënde, policia në Kosovë, por edhe agjentët e saj jashtë do të kishin marrë masa kundër teje. Duke mos pasur njohuri për ty ia arrite me e bërë gjithë atë punë për atë kohë, ia arrite me e ndriçua të vërtetën e asaj kohe pas 30 vitesh, gjatë kësaj periudhe 2011-2014.*"

2-18.Puna ime intelektuale si individ i lirë

Në korrik të vitit 1983 unë pata kërkua dorëheqje nga Qendra Ekzekutive (udhëheqësia e LRSSHJ), dhe shpresoja se ajo udhëheqje do ta vazhdoj punën më mirë pa mua. Meq nuk u pranua kërkesa për dorëheqje vazhdova punën me tërë kapacitetin tim. Ngjarjet rrodhën në një formë, të cilën e kam shtjelluar në libra tjerë dhe nuk po ndalem këtu. Nga qershori 1984 deri në korrik 1985 e kam udhëhequr Zërin e Kosovës (formati A3) që ka dalë fillimisht në Paris e më vonë në Suedi.

Pas korrikut 1985 shokët që e kanë përkrahur gazetën e drejtuar nga unë janë organizuar në një formë tjetër dhe kanë shpresuar në persona kundër të cilëve unë jam përgjegj me shkrim.

Edhe pse kam mbetur i vetëm në disa qëndrime kjo nuk më ka frikësuar asnjëherë.

Shkëputja ime prej aktivitetit të organizuar, dhe veprimtaria e përkushtimi im si individ i lirë ka rezultuar se ka qenë i mirë si për mua si për shokët.

Shokëve kam qenë i gatshëm çdo herë me ua lëshua rrugën. Kundërshtarëve jo.

Pjesa kryesore e shokëve janë organizuar dhe kanë bërë aktivitete të ndryshme praktike, gjatë viteve 1986-1988. Nga viti 1989 këta shokë kontaktohen dhe aktivizohen tërësisht me partitë e ndryshme që formohen në Kosovë e toka shqiptare.

Është e kuptueshme se në politikë e luftë për liri rëndësi ka masa, organizimi dhe ku shumica e aktivistëve organizohen e bashkohen.

Duke u mbështetur në rrethanat e mia të përgjithshme e kam bërë atë që ka qenë më e përshtatshme, më e drejta.

Në Suedi, në Stockholm - ku kam lidhje familjare - si individ i lirë, duke u nisur nga edukata bazike e popullit, e vendit që më ka lindë, i kam përcjellë situatat në viset shqiptare dhe në përgjithësi. Në Suedi jam thelluar në punë dhe në vazhdimin e studimeve (me ndërprerje e reduktime të mëdha si pasojë e pengesave të natyrës) për të mbledhur dije, i bindur se atë dituri një ditë do ta përdori për të mirë, e se do të jetë e dobishme për popullin-njerëzit.

Jam marrë, pos studimeve në kohën e lirë, me ushtrimin e profesionit të përkthyesit, ku shkatërrimi i RSFJ, luftërat në Kroaci, Bosnje e Kosovë, me shumë e shumë plagë njerëzore të shkapërderdhura nëpër refugjatë, një pjesë e madhe, përmes meje janë shkarkuar në sistemin juridik dhe shëndetësor të Suedisë. Kam përkthyer për shqiptarë, boshnjak, kroat, serb, maqedon, turq, rus etj.

Si person i penës, e si krijues opinionesh, kam pasur mundësi të zhvilloj punë intelektuale individuale. Këtë punë dhe për këtë punë kam mundur të përgatitem edhe si individ.

Shokët në Shtutgart, në Gjermani e në Zvicër i kanë vazhduar aktivitetet e tyre edhe pa mua në organizime të ndryshme, që kanë përfshi pos tjerësh Ibrahim Rugovën dhe Adem Jasharin, dhe unë kurrë nuk jam përzier me qëllim të ndonjë lakmie për pjesëmarrje në meritat e hiset e tyre.

Si individ kam ndihmuar me të gjitha mundësitë dhe format luftën kundër krimeve e dhunës serbe në Kosovë.

Punën time, të qetë e të vendosur, -në dukje të heshtur pas vitit 1985-, (megjithëse me reduktime të mëdha, si shkak i rrethanave natyrore), punën time të pa zhurmë, pa lakmi për reklamime, disa e kanë keqinterpretuar, dhe ky keqinterpretim i ka çuar, krejtësisht me fjalët e tyre, në vetëdemaskim.

Më 17 nëntor 2001 në Kosovë, nën mbrojtjen e NATO-s janë mbajtur zgjedhje të lira, ashtu siç janë mbajtur nën këtë mbrojtje edhe më 9 shkurt 2025.

2-19.Adem Jashari dhe Imer Berisha

Sami Lushtaku tregon për herë të parë: Rugova dhe Adem Jashari u takuan në Zvicër

*Sami Lushtaku, ka treguar për herë të parë se në vitin 1991, presidenti **Ibrahim Rugova** e ka pritur në Zvicër komandantin **Adem Jashari.***

Lushtaku thotë se më herët nuk është përmendur ky rast, por në fillim të '90-tave Rugova e Jashari janë takuar në Zvicër.

*"**Kemi shku në Zvicër me Adem Jasharin.** Atje e kemi taku qeverinë edhe **Ibrahim Rugovën.** **Unë jo, por Ademi (Jashari) e ka taku Rugovën në vitin '91",** ka thënë Lushtaku në Pressing. Ai tregon se ishte arratisur përmes aeroportit të Shkupit dhe po shoqërohej nga **Adem Jashari**. Kur kanë arritur në Zvicër, sipas Lushtakut, janë pritur nga qeveria në ekzil e Kosovës dhe vetë presidenti Rugova.*

***"Nuk e kemi ditë që atje e pret Rugova. Kur kemi shku në aeroport na ka pritur Imer Berisha. Atje na ka pritur edhe Ibrahim Rugova"**, ka treguar Lushtaku.*

(Drenicapress.info, 23 shtator 2019)



Adem Jashari dhe Imer Berisha

Elected Candidates
Kandidatët e Zgjedhur
Izabrani Kandidati

Election 2001 **Zgjedhjet 2001** **Izbori 2001**

---

11. LKÇK — **LËVIZJA KOMBËTARE PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS**
National Movement for Liberation of Kosovo
1. FATMIR HUMOLLI *

12. IRDK — **INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS**
New Initiative for a Democratic Kosovo
1. BISLIM HOTI *
2. XHEVDET NEZIRAJ

14. PDASHK — **PARTIA DEMOKRATIKE ASHKANLI SHQIPTARE E KOSOVËS**
Ashkali Albanian Democratic Party
1. SABIT RRAHMONI *
2. FAIK MAROLLI *

15. LPK — **LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS**
People's Movement of Kosovo
1. BEDRUSH ÇOLLAKU *

20. PDK — **PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS**
Democratic Party of Kosovo
1. HASHIM THAÇI
2. ARSIM BAJRAMI
3. FLORA BROVINA
4. HAJREDIN KUQI
5. JAKUP KRASNIQI
6. DRITA STATOVCI
7. FATMIR LIMAJ *
8. ALI JAKUPI
9. TEUTË HADRI
10. BAJRAM REXHEPI *
11. ISMAJL KURTESHI *
12. NERXHIVANE DAUTI
13. SEJDULLAH HOXHA
14. BAJRUSH XHEMAILI
15. SALA AHMETAJ *
16. HYDAJET HYSENI-KALOSHI
17. SHEFKI SEJDIU
18. EXHLALE SALIHU
19. EMIN KRASNIQI *
20. XHAVIT HALITI
21. HATIXHE HOXHA
22. BERAT LUZHA
23. GANI KOCI
24. SABILE BASHA
25. LIRAK ÇELAJ
26. DRITON LAJÇI

22. КП — **КОАЛИЦИЈА ПОВРАТАК**
Coalition Return
1. GOJKO SAVIĆ
2. GORAN LAZOVIĆ
3. SMILJKA MILISAVLJEVIĆ
4. MOMČILO SAVIĆ
5. NENAD RADOSAVLJEVIĆ *
6. LJILJANA KENIĆ
7. PETAR RADOSAVLJEVIĆ *
8. RADA TRAJKOVIĆ
9. MILOVAN JOVANOVIĆ
10. STOJANKA PETKOVIĆ
11. SOKOL ĐORĐEVIĆ
12. BOGOLJUB MILOŠEVIĆ
13. SLOBODAN BJELIĆ
14. OLIVER IVANOVIĆ
15. CVETA VUJACIĆ
16. RANDJEL NOJKIĆ
17. DEJAN MITIĆ
18. IVANA MARKOVIĆ
19. SVETOMIR SAMARDŽIĆ
20. LJUBOMIR STANOJKOVIĆ
21. VESNA JOVANOVIĆ
22. DRAGIŠA KRSTOVIĆ

* Candidate has dual mandate
* Kandidati ka mandat të dyfishtë
* Kandidat ima dvojni mandat

23. LDK — **LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS**
Democratic League of Kosovo
1. IBRAHIM RUGOVA
2. KOLË BERISHA
3. NEKIBE KELMENDI
4. NEXHAT DACI *
5. SABRI HAMITI
6. EDI SHUKRIU
7. FATMIR SEJDIU
8. NAIM JERLIU
9. FETIJE KËPUSKA
10. BEHXHET BRAJSHORI
11. YMER MUHAXHERI
12. SANIJE ALIAJ *
13. FADIL GECI *
14. AQIF SHEHU *
15. EDITA TAHIRI
16. FADIL KRYEZIU
17. ALUSH GASHI
18. MELIHATE TËRMKOLLI
19. FATMIR REXHEPI *
20. NIMON ALIMUSAJ
21. SOFIJE HARGJI
22. AGIM KRASNIQI
23. RAMADAN KELMENDI *
24. NAFIJE BERISHA
25. ALI SADRIU
26. HAKI SHATRI
27. SAMIJE ZEQIRAJ
28. IBUSH JONUZI
29. SADUDIN BERISHA
30. REMZIJE NIMANI
31. UKË BYTYÇI *
32. LULZIM ZENELI
33. MEVLYDE SARAÇI *
34. JUSUF SUTAJ *
35. GANI PREKOPUCA
36. GJULSHEN BERISHA
37. SMAJL HAJDARAJ *
38. ILMI AHMETI *
39. BESA GAXHERI
40. TOMË HAJDARAJ
41. MEHMET NEZIRI
42. ZYHRIE MALOKU
43. HALIL AHMETI
44. SABIT RRUSTEMI
45. NURISHAHE HULAJ
46. ESAD DAUTI
47. BLERIM BARUTI *

24. PREBK — **PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVES**
The United Roma Party of Kosovo
1. ZYLFI MERXHA *

28. PD — **PARTIA E DREJTËSISË**
Justice Party
1. SYLEJMAN ÇERKEZI

29. AAK — **ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS**
Alliance for the Future of Kosovo
1. RAMUSH HARADINAJ
2. BAJRAM KOSUMI
3. ZYLFIE HUNDOZI
4. MUHAMET KELMENDI
5. BUJAR DUGOLLI
6. SEBAHATE KRASNIQI-GRAJÇEVCI
7. NAIM MALOKU
8. MAHMUT BAKALLI

30. PSHDK — **PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS**
Christian Democratic Party of Kosovo
1. MARK KRASNIQI

33. VTN — **VATAN**
1. ZEHRA ELEZI
2. DŽEZAIR MURATI
3. RUSTEM IBIŠI *
4. NUMAN BALIĆ

34. BSDAK — **BOŠNJAČKA STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE KOSOVA**
Bosniac Party of Democratic Action of Kosovo
1. HILMO KANDIĆ *

34. KDTP — **KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ**
Turkish Democratic Party of Kosovo
1. MAHİR YAĞCILAR
2. GANİ SADIK
3. NAFIYE GAŞ

Në emër të popullit; Aktgjykimi i **Gjyqit të Popullit**, më 17 nëntor 2001

2-20.Iluzioni i qëndrueshëm

Qëndrueshmëria e kujtesës
Salvador Dali, The Persistence of Memory- The Museum of Modern Art, New York City

Albert Einstein (1879-1955)

The distinction between past, present, and future is only an ILLUSION, however persistent.

Dallimi në mes të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes është vetëm një ILUZION, megjithëse i qëndrueshëm.

The only reason for time is so that everything doesn't happen at once.

I vetmi shkak për kohën është që të mos ndodhin të gjitha përnjëherë.

3.DRITA

3-1.Ndriçimi i mendjes-Iluminizmi

Epoka e Iluminizmit (pra Epoka e Arsyes dhe Ndriçim-mendjes) ka qenë një lëvizje intelektuale dhe filozofike që ka ndodhë në Evropë prej fundit të shekullit 17 deri në fillim të shekullit 19. Iluminizmi, i cili ka vlerësuar diturinë e fituar përmes racionalizmit dhe empirizmit, është preokupuar me një varg idesh sociale dhe ideale politike siç janë e drejta natyrale, liria dhe progresi, toleranca dhe vëllazërimi, qeverisja kushtetuese dhe ndarja formale e kishës prej shteti.

Në odën e Madame Geoffrin më 1755, Leximi i tragjedisë së Volterit, L'Orphelin de la Chine; në sallonin e Marie Thérèse Rodet Geoffrin, nga Anicet Charles Gabriel Lemonnier, rreth 1812

Iluminizmit i ka parapri Revolucioni Shkencor, duke përfshi vepra nga Johannes Kepler, Galileo Galilei, Francis Bacon, Pierre Gassendi, Christiaan Huygens dhe Isaac Newton, pos tjerësh si dhe nga filozofët Descartes, Hobbes, Spinoza, Leibniz, dhe John Locke.

Doktrinat qendrore të Iluminizmit kanë qenë liria individuale, qeverisja reprezentative, sundimi i ligjit e liria fetare.

Në mesin e figurave intelektuale të Iluminizmit përfshihen pos tjerësh Cesare Beccaria, George Berkeley, Denis Diderot, David Hume, Immanuel Kant, Lord Monboddo, Montesquieu, Jean-Jacques Rousseau, Adam Smith, Hugo Grotius, dhe Voltaire.

Një prej publikimeve më me influencë ka qenë *Encyclopédie.* Është botuar në mes 1751 e 1772 në 35 vëllime, e përpiluar nga Diderot, Jean le Rond d'Alembert, dhe një ekip prej 150 të tjerësh.

3-2.Fjalët e Qiririt

Fjalët e Qiririt, nga Naim Frashëri

Në mes tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj ditë.

Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,
Njëri-tjatërin të njihni.

Për ju do të rri të tretem,
Asnjë çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot.

Unë zjarrit nuk i druhem
Dhe kurrë s'dua të shuhem,
Po të digjem me dëshirë,
Sa të munt t'u ndrinj më mirë.

Kur më shihni se jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur;
jam i gjall' e jam ndë jetë
jam në dritët të vërtetë,

Unë jam në shpirtin tuaj,
Mos më kini për të huaj,
M'është falurë durimi,
Andaj po digjem si trimi,

Se ma k'ënda t'u bënj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë.
Jakëni rreth meje rrini,
Flisni, qeshni, hani, pini,

Në shpirt kam dashurinë,
Pa digjem për njerëzinë,
Lemëni të përvëlohem,
nukë dua më të ftohem,

Dua ta djek trupn' e kretë
Për atë zotn' e vërtetë.
Me zjarr ta djek mushkërinë
E të tretem për njerinë,

Bashkë me gëzimt të tija
të vete te perëndia.
Unë dua njerëzinë,
Mirësin' e urtësinë.

Në bëhi shokë me mua,
Në më doni si u dua,
Njëri-tjetërin në doni,
Të paudhë mos punoni.

O zëmëra fluturake,
Qasju pakë kësaj flake!
Mase krahët t'i përvëlon,
Po dhe shpirtin ta shënjtëron.

Unë duke përvëluar,
Njerëzit i kam ndrituar.
Kam qënë mik me njerinë,
Andaj i di e më dinë.

Gjithë tuajt' i kam parë,
Mëm' e at' e fis e farë,
Si tani gjithë i kam ndër mënt,
Që rrininë më këtë vënt.

Edhe sot nër ju ata shoh,
Se shpirtin e tyre ua njoh,
Dhe unë si ju jam ndruar
E jam përzjer' e ndryshuar,

Pa jam bërë shumë herë
Zjar e uj' e balt' e erë.
Jam një shkëndijë pej qielli
dhe një drudhëzë pej dielli.

Edhe ndër qiej fluturonj,
Edhe brënda në det qëndronj,
Shumë herë fle në baltë,
Diku ndodhem dhe në mjaltë

Bënem qëngj e kec i pirë,
Lul' e bar e gjeth i mbirë.
Dua shumë fjalë t'u them,
Po trëmbem mos i bënj ujem.
E ku shkruhenë në kartë
Fjalët' e gjuhësë zjarrtë?

3-3.YJET E PASHUARA TË RESUL BEDOS

Resul Bedo ka lindur në vitin 1926 në fshatin Fushë-Bardhë të Gjirokastrës. Në moshën 15-vjeçare, ishte nga të parët që u rreshtua në çetën "Çerçiz Topulli", më pas në batalionin "Asim Zeneli" dhe më vonë në Brigadën e 6 Sulmuese. Gjatë luftës mori pjesë dhe në betejat në Jugosllavi. Ndërsa pas çlirimit të vendit do të ishte nga ushtarakët që morën pjesë në përballjet me Greqinë gjatë provokacioneve në kufi, më vitin 1948. Krijimtarinë e tij e nisi që në moshë të re në botimet e shtabeve të ushtrisë, për tu bërë më pas një nga autorët më të spikatur të historisë së luftës dhe heronjve të saj. Ndërroj jetë më 10 janar 2017 në Tiranë.

Ish-Luftëtari Resul Bedo/ Rrëfimet e partizanit për botimin e "Yjeve të Pashuar"

Arkiva/ Intervista e dhënë nga koloneli në pension Resul Bedo: Iniciativa për të botuar 19 vëllimet me "Yjet e Pashuar" në dy regjime.

Leonard VEIZI

Ka të botuar të paktën 75 tituj librash, ndër të cilët 19 kanë të dokumentuar jetën e dëshmorëve shqiptarë të rënë në Luftën e Dytë Botërore, nën titullin "Yje të Pashuar". Për një kohët të gjatë ka shërbyer si ushtarak karriere në ushtri, ndërsa për shumë vite ka shërbyer në sektorin e kulturës në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, me gradën e kolonelit. Në vitet e luftës ka qenë i inkuadruar me çetën "Çerçiz Topulli", më pas me batalionin "Asim Zeneli" dhe së fundi si komisar kompanie me Brigadën e 6-të Sulmuese. Por paralelisht, e dendur ka qenë dhe jeta e tij e krijimtarisë letrare. Aktualisht, edhe pse 83 vjeç, është po aq aktiv në mbrojtjen e dinjitetit të dëshmorëve. "Duam apo s'duam ne, dëshmorët janë të bashkuar. Ata kanë rënë për një qëllim të përbashkët: për kombin shqiptar, për lirinë dhe demokracinë", shprehet koloneli në pension Resul Bedo, gjatë një interviste ekskluzive për gazetën "Telegraf".





Si filloi puna për "Yjet e Pashuar"?

Dëshmorët e atdheut dhe heronjtë e kombit kanë qenë objekt i punës sime, thuajse të përhershme, duke filluar që në vitet e Luftës, ku diçka kam shkruar. Megjithëse unë kam shërbyer në detyra komanduese në ushtri, gjithnjë më ka ngacmuar çështja e dëshmorëve. Kështu grumbullova materiale të shumta si në rastin botimit "100 episode partizane", ku të gjithë ishin me fotografi. Pastaj, duke shkruar vazhdimisht, si "Shqiponjat e vogla" e të tjera tregime, vura re se u bënë një sasi e madhe. Atëherë mendova t'i hidhja në një vëllim. Në një

Përvjetor të Çlirimit e përgatita për shtyp duke e titulluar “Krahët e shqiponjës”. M’u duk si një titull tepër i gjetur, duke u bazuar në fjalët e Pirros së Epirit, që u tha ushtarëve: “Nëse ju më quani mua shqiponjë, ju ishit krahët e mi”.

Kur vendosët ta ndryshonit titullin?

Menjëherë pasi një miku im që e pa vëllimin para se ta çoja në shtyp, më bëri një vërejtje duke më thënë: “Këta dëshmorë janë të vrarë të gjithë dhe krahët e shqiponjës s’mund të fluturojnë. Mos të krijon ndonjë keqkuptim një gjë e tillë?” Kjo vërejtje miqësore më bëri të zmbrapsem. Kështu ia ndërrova titullin duke e cilësuar “Yje të pashuara”. Materiali ishte i shumtë, kështu që dolën dy vëllime me të njëjtin titull. Ishte e para herë që përdorej në mjetet e informacionit një shprehje e tillë. Në fillim mendoja se si do kapej kjo nga lexuesit, por interesante ishte se ajo u përshtat shumë shpejt dhe u bë e plotfuqishme. Kjo gjë më dha dorë. Vazhdova të punoja sërish dhe kjo solli për rrjedhojë dhe botimin e katër vëllimeve të tjera.

Si do të procedohej për dy vëllimet e para. A kishte censurë?

Ato i shpëtuan censurës. Të dy vëllimet u dërguan për t’u botuar në Kinë, me një cilësi maksimale. Në atë kohë Kina i jepte Shqipërisë tanke e aeroplanë dhe jo më të shtypte dy vëllime me cilësi të lartë. Por më pas shtypshkronja erdhi në Shqipëri dhe nuk patëm probleme me cilësinë e botimit

Si priteshin nga udhëheqja këto vëllime?

Natyrisht që u pritën mirë. Por në vëllimin e tretë kishte një koincidencë. Ndërsa Hysni Kapo më dërgoi një letër ku më përgëzonte për punën time, Enver Hoxha nuk ishte në dijeni. Dhe një gjë e tillë doli gjatë vizitës që ai bëri në ekspozitën “Shqipëria Sot”, ku ishin ekspozuar dhe tre vëllimet e Yjeve të Pashuara. Unë nuk kam qenë dëshmitar okular, por më treguan se Enveri thirri Ramiz Alinë, duke i kërkuar llogari se përse nuk i ishte bërë e ditur se kishte dalë dhe vëllimi i tretë i “Yjeve të Pashuar”.

A kishit peripeci në përzgjedhjen e materialit?

Natyrisht kishte shumë peripeci. Unë kam hulumtuar në të gjithë Shqipërinë, përveç materialeve që më vinin në zyrë. Një gjë të tillë e bëri të mundur dhe dalja ime si shkrimtar i lirë. Më vonë u angazhova dhe në Komitetin Kombëtar të Veteranëve. Por kur u bënë 6 vëllime, botimi i “Yjeve të Pashuar” u ndërpre padrejtësisht. Burokracia e kishte bërë punën e saj. Kështu u krijuan probleme nga më të ndryshmet. Të paktën për ta u duk se u kënaq opinioni me 6 vëllime, ndaj më thane: “Mjaft!”. Ose më saktë, u tha: “Vazhdimi i këtij libri na sjell telashe” Ndërsa për mua ato nuk ishin mjaft. Unë synoja më tepër. Në atë kohë kërkoja të realizoja botimin e 10 vëllimeve.

Në të vërtetë cila ishte arsyeja e vërtetë e ndalimit?

Unë i merrja të dhënat nga baza. Familjet kishin dëshmi autentike. Madje për këtë Ministria e Mbrojtjes më vuri në dispozicion 2-3 ushtarë, me prirje letrare, të cilët më ndihmonin për të seleksionuar materialet. Por në këtë të dhëna ndonjëherë vihej re se diçka nuk shkonte. Ishte propaganduar tjetër gjë, por dilte tjetër gjë. Të vogla në dukje, por krerët nuk mund t’i duronin, përderisa gjërat kishin ndryshuar dhe nga gjiri i partisë kishin dalë “grupet e tradhtarëve”. Dhe kështu u mendua që “Yjet e Pashuara” të ndaleshin me kaq.

A kishit siguruar “visto” nga lart?

Botimi ishte me iniciativën time. Sapo u njoh me materialin, Enver Hoxha tregoi interes për të dhe kërkoi që, nëse dilte ndonjë vëllim i ri, t’i vihej menjëherë në dispozicion. Mund të them se Enver Hoxha e ndiqte më vëmendje serinë e këtij botimi. Por megjithëse e kisha këtë “visto”

nga Sekretari i Parë i KQ, një pjesë aparatçikësh e bënë punën e tyre. Dhe diku nga viti 1985, kur dhe Enver Hoxha nuk jetonte më, botimi u pezullua.

Kishit ndërhyrje nga KQ për materialet e përzgjedhura?
Mendoj se kishte një farë dashamirësie ndaj kësaj pune. Përndryshe nuk mund të bëhej i mundur botimi. Por gjithsesi iniciativa ishte dhe mbeti thjesht e imja. Ndërkohë, nuk kishte asnjë privilegj dhe ashtu siç botoheshin dhe librat e tjerë, botohej dhe "Yjet e Pashuar". Në këtë përpjekje timen morën pjesë dhe shumë familjarë të dëshmorëve të Luftës, të cilët më sollën materialet konkrete.

Si e rifilluat botimin e ciklit?
Ndalesa disavjeçare krijoi përshtypjen se nuk do të kishte më vazhdimësi. Por unë nuk isha dakord me këtë. Kur krijuam shoqatën, unë e shtrova problemin ku kërkova që të rivazhdonte botimi "Yjet e Pashuar". Vërtet nuk kisha mundësi financiare, por dalëngadalë arrita që në vitin 1996 të nxirrja vëllimin e 7-të. Rifillimi i ciklit pas rreth 10 vjet ndërprerje, krijoi dhe interesin e njerëzve të cilët deri në atë kohë kishin menduar se nuk do të kishte më "Yje të Pashuar". Mendoj që, po të kem jetëgjatësi, të bëj të mundur botimin e 30 vëllimeve.

3-4.IK O NATË PO KËNDON AGIMI

Me bukurinë tonë të virgjër, të virgjër
vdekjen po ushqejmë
se kjo tokë ka të ftohtë
(Fatos Arapi)

Dora e zezë e xhandarmërisë jugosllave derdh rrebeshe torturash barbare mbi kokat e më se 70 femrave shqiptare të mbyllura në burgun e Mitrovicës.

Ky lajm i praptë prek thellë në sedrën tonë kombëtare.

UDB-ja, e cila me dekada nuk u njoftua me dëmtimin e meshkujve të zgjedhur shqiptarë ndër kampet e veta të përqendrimit, sot u kujtua për të vënë dorë edhe përmbi femrën shqiptare.

Po në gjithë këtë ankth acari mbi Kosovën martire, ballin na e ndrit një sihariq: "Ohoo! Lindi bija, porosi e kohës për kombin, mësoi nga etnit liri e pushkë".

Shqiptarja kosovare, e cila deri më dje ishte në terrin e plotë të padijes, kurse sot ka zënë të ecë fare natyrshëm në tribunat më të larta shkencore e kulturore, e kuptoi përfundimisht se duhet të dalë kudo krah me të vëllanë, me të shoqin e të birin, në të gjitha frontet dhe me qëndrimin e patundshëm. Një komb unik shqiptar – në një shtet unik! Ky akt i burgosjes masive edhe të femrës shqiptare në Jugosllavi, tregon qartë se kanë rënë përfundimisht në ujë gjithë kombinacionet e fëlliqura jugosllave
(që nga viti 1912 e këtej), të cilat shkollimin e femrës shqiptare e shihnin si një nga mjetet e rëndësishme për çkombëtarizimin e shqiptarëve. E si të mos dështonin, pasi penat e mprehta, që pushteti i Jugosllavisë së vjetër dhe ky i Titos i kishin angazhuar të bënin hulumtime e projekte shkencore për asimilimin dhe për shfarosjen e shqiptarëve, nuk kishin parashikuar dot që do të vinte dita që femra shqiptare e Kosovës, e mbrujtur nga një brumë fisnik, në vend që ta përqafojë kuaziemancipimin jugosllav, shkollimin e vet e pa si një detyrë të shenjtë, të cilën duhet vënë në shërbim të popullit dhe të çlirimit social e nacional.

Pushtetmbajtësit e sotëm jugosllavë do të kishin qenë shumë më të kënaqur sikur projektet dhe masat e tyre shfarosëse të kishin qenë më pak drastike e të orientoheshin vetëm në neutralizimin e intelektualit shqiptar në Kosovë e kështu edhe të femrës sonë. Ndoshta në atë mënyrë do të korrnin suksese shumë më të mëdha. Por, barbari nuk mund të jetë kurdoherë

i vetëdijshëm se dhuna sjell dhunë, gremina sjell greminë. Gjithë ç'përjetuan nga pushteti i Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene, si dhe nga socialimperializmi titist, s'ishte pos dhunë e greminë.

Dëshmia më e mirë për shëndetin politik, social e nacional të shqiptares së Kosovës sot është inkuadrimi i saj i drejtpërdrejtë në lëvizjen e gjerë për çlirimin social e nacional të shqiptarëve nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me vendin amë, Shqipërinë. Dhe ky akt i saj bëhet më madhështor kur dimë se gjithë përpjekjet nacional-shoviniste të pushtetit jugosllav ishin të përqendruara në degjenerimin, përkatësisht në apolitizmin e rinisë kosovare. Veçanërisht qëndrimi ndaj femrës sonë ishte i atillë që asaj i ofronte mundësi të shfrenuara për shfrime instinktesh të ulëta pa kurrfarë përgjegjësie shoqërore, mundësi që krijonin një bazë të fortë për amoralitet total, për degjenerimin, që do t'u jepte dorë projekteve shtetërore jugosllave për asimilimin e shqiptarëve.

Kjo- siç është fare e natyrshme në kushtet e jetesës brenda kufijve politikë të Jugosllavisë, ku degjenerimi ka zënë të lulëzojë me të madhe – nuk do të thotë se krimbi i lig nuk ka zënë të brejë edhe një pjesë të rinisë sonë. Mirëpo, nuk kemi pse të brengosemi, sepse shkalla e degjenerimit te i riu dhe te femra jonë nuk përkon as për së afërmi me shpresat e mëdha që ushqen Jugosllavia në këtë drejtim.

Përkundrazi. Sado që terrenin e ka përgatitur me kujdes për një mekje të madhe dhe për një përgjumje kombëtare e shoqërore, pushteti titist te femra shqiptare me dhunën e ushtruar ka arritur një efekt krejt të kundërt me qëllimet dhe synimet e veta. Polici, agjent i shkon femrës sonë në shtëpi, "i kërcen nga muri, ia përmbys shtëpinë, ia vë koburen në gjoks dhe i kërkon burrin, djalin, vëllanë. Ajo mbase deri në atë çast nuk dinte akoma pse lufton djali, burri, vëllai. Ajo rrinte në shtëpi, në punën e vet…" Në shkollë, në zyrë, në institut. Njëherë kishte qenë e re, mendja i kishte thënë se duhet ta ndrydhë rininë e vet, sepse rrjedhë tjetër të ngjarjeve nuk mund të ketë, se shqiptari është qytetar i dorës së dytë, i dorës së dhjetë në Jugosllavi, se zyrat nuk e kuptojnë dhe nuk e durojnë shqip, se malli në shitore nuk ka si të kërkohet shqip, shqipja duhet të flitet me zë të ulët, shqipes duhet t'i vijë marre nga serbishtja, e cila qenka gjuhë qytetërimi. Pushteti jugosllav ishte kujdesur që shqiptari të mos mund ta shijojë cicërimin e bukur shqip të poetëve të Rilindjes, të atyre të Realizmit. Po pastaj kish qëlluar që femrës, i vëllai, shoku i shkollës, i kishin futur fshehur në çantë poezitë e Migjenit, Naimit, Qajupit, romanet e Xoxës, Kadaresë. Dhe ajo kuptoi menjëherë që "shiftari" dhe "albanci" flitkan krejt njësoj, prandaj u dashka të jenë një. Dhe, bashkë me të vëllanë, me shokun e bankës, kishte bërë presion, kish dalë në demonstrata: Në shkollë dua të mësoj për Naimin, Kadarenë, së paku aq sa për Duçiqin, Andriqin, Qosiqin. Fakti që ia fshehnin historinë, traditën, përkatësinë e përbashkët kombëtare me gjithë shqiptarët në botë, e në radhë të parë me vëllezërit në RPS të Shqipërisë, femrën shqiptare e bëri t'i hapë sytë mirë e mirë dhe të bindet se Jugosllavia paska siklet të madh, tuk se i kushton kujdes e mund aq të madh fshehjes se çdo gjëje që mban vulën shqiptare. Atëherë femra jonë zuri të mësojë dalëngadalë për historinë e ndritshme të popullit të saj, mbi të cilin kishin rënduar shekujt e robërisë, por s'e kishin përkulur kurrë, për historinë e popullit që ishte bërë theror për Ballkanin dhe Evropën, duke ia ndalur hovin kuçedrës anadollake pesëqind vjet me radhë, kurse në fund, kur i kish ardhur dita, pas shumë gjakderdhjesh, të formojë shtet më vete (më 1878, më 1912 dhe më 1944) fqinjët shovinistë – serbi, malazezi, bullgari e greku kishin gjetur ditën për t'i rënë në qafë për t'ia rrëmbyer si qentë e tërbuar nga një copë të madhe toke. Më vonë, duke parë qartë qëllimin pse i burgosnin të vëllanë, të shoqin, shokun e shkollës, ajo tha: "S'durohet më, duhet mbaruar me këto siklete. Qau hallet me fqinjën e saj, mikeshën dhe mori vesh se kudo kish lotë e zi, kudo urrejtje e

mjerim- kish burrin të burgosur… shtëpinë të grabitur. I mungonte edhe fqinjës, mikes… buka e mirë, mishi, gjalpi, vaji dhe kripa, i mungonte çorapja dhe këpuca, rroba e shtresa…" Se Kosova ishte në zi. Dhe s'qe shumë zor për gruan shqiptare të njihte se kush qe shkaktari, e njohu, e urrejti dhe u betua…"Do ta ndiqte, në rast nevoje do ta vriste." Prandaj e ndjeu nevojën të radhitej në prapavijat e frontit të bijve të saj, të radhitej edhe në krahun e tyre… "Jo vetëm pse kështu bëhej me djemtë e vet, por pse ajo njohu Jugosllavinë "si armiken e betuar të popullit, mbi të gjitha, si armikun numër një të saj", të femrës shqiptare.

"Oficeri serb u dha urdhër ushtarëve të hyjnë me të fortë në Konsullatë… Familjet shqiptare që ishin brenda u vranë pa mëshirë. Edhe të plagosurit i vranë dhe i therën në shtrat. Gratë e fëmijët i vranë… Disa nga serbët edhe i ndynë kufomat!" Kështu kishin vepruar serbët tamam në kohën që kishin përfituar nga lufta e "Prometheut kundër të gjithë perëndive", nga lufta pra e popullit shqiptar kundër turkut, në radhë të parë, e pastaj edhe kundër serbit, malazezit, bullgarit që i përkrahte me të madhe "majka Rusija" e që donin të shkelnin tokat shqiptare (më 1912) dhe tamam atëherë që i thoshin botës se shqiptarët nuk janë gjë tjetër pos disa fise barbare, që s'dinë ç'është civilizimi dhe s'meritojnë të kenë shtet të pavarur.

Dhe ky ishte vetëm prologu i tmerreve që do të shihte populli shqiptar i Kosovës, i cili hyri në robërinë e gjatë dhe të errët jugosllave pikërisht ditën që në Shqipëri u shpall pavarësia, më 1912. Kusuri i këtyre tmerreve është shënuar në kujtesën e gjyshërve dhe të etërve tanë, si dhe në rezistencën heroike të popullit në krye me Shotë dhe Azem Galicën etj. Në një anë, Shota u shtrëngua të dalë krah me burrin në mal, për të luftuar me dhjetëra vjet kundër armikut barbar – xhandarmërisë dhe ushtrisë jugosllave, për ta vazhduar bashkë me çetat e lirisë këtë luftë të rëndë heroike edhe pasi u vra i shoqi, heroi Azem Galica. Në anën tjetër, nëna shqiptare, e cila e di se "gjaku i trimave s'humb më kot, por tokës i jep jetë", ia këndoi të birit këngën e arratisë, këngën e fshatrave dhe qyteteve të djegura bashkë me pleq, gra e fëmijë nga xhandarmëria dhe nga ushtritë koloniste serbe e malazeze, këngën e vargut të pakëputur të barbarizmave sllave nga më të mëdhatë që ka përjetuar mbi kurrizin e vet rruzulli tokësor. Po vetë s'u dha që s'u dha: rrembat e tokës stërgjyshore ia ushqen nënës, gruas e vajzës shqiptare dashurinë e madhe për tokën, për gjuhën, për doket dhe zakonet e të parëve. Detyrë e saj kryesore ishte bërë që, në një kohë rremetesh në skllavërinë jugosllave, atë dashuri t'ia përcillte djalit dhe vajzës bashkë me gjirin që u jepte! S'deshi të dijë për vuajtje e masakra, ato iu bënë bukë e përditshme. Dhe , tha: "Të zhbirosh me sytë e zemrës, është më mirë se sa të fyesh nga kurrkushi" dhe qëndroi sypatrembur e kokëlartë. Aq bukur e aq natyrshëm i dilte asaj kënga e nënës që duhet për nderin e të birit:

S'di në luftë në ka rënë,
S'di me nder në ka luftuar,
Mos armiqve u është dhënë,
Mos gjëkundi është harruar?
Sa për nder të Shqipërisë
Në ra djali "falur qoftë"
Se nga zemra s'them të keqen
Shqipëria veçse rroftë!

Sëfundi shpresat e shqiptarit u tradhtuan pas Luftës II Botërore. Bashkë me vëllezërit nga Shqipëria, shqiptarët e Kosovës kishin luftuar për tokat e veta të begata dhe kishin pritur ta gëzonin jetën dhe shtetin e përbashkët shqiptar. Por, ndonëse tokën tonë e lamë me gjakun tonë

të shtrenjtë, duke ndihmuar edhe për çlirimin e popujve të Jugosllavisë, sllavi e greku, me ndërmjetësimin e fuqive të mëdha… sërish i shtrinë kthetrat e tyre mbi tokat tona dhe na vunë kufirin me Nënën Shqipëri, stabiliteti dhe mbarësia shtetërore e së cilës jo vetëm që dëshmojnë se shqiptarët dinë të qeverisen dosido, por ata në këtë punë mund të mbajnë edhe flamurin e nderit.

Por, sikundër më herët, pushtuesi jugosllav ka bërë edhe kësaj radhe një llogari të gabueshme. Kur i pushtoi, me ndihmën e të tjerëve dhe duke u shërbyer me tradhti, tokat shqiptare të Kosovës, të cilat i la të ndara në banovina ndërmjet Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, për t'i bërë sa më lehtë zap, ai harroi ç'kishte bërë ndër shekuj shqiptari kundër pushtuesve shumëfish më të zotët – romakë, bizantinë e turq dhe me logjikën e një fodulli, pandehu dhe tha: "Gjatë një brezi të gjitha punët do të ndreqen", ""Për dy vjet, në katundet e pushtuara, asnjë nuk do të guxonte të fliste shqipen". Dy vjet???

Jemi dëshmitarë se nga ai kërcënim kanë kaluar plot 68 vjet presioni çnjerëzor për shfarosjen dhe asimilimin e shqiptarëve, kurse gjuha shqipe sot flitet më thekshëm se kurdoherë në trojet shqiptare të Kosovës! Dhe për të gjithë këtë vitalitet, në masë të madhe i detyrohemi nënës, motrës, gruas shqiptare. "Ato që vdisnin sikur s'kishin jetuar kurrë, kur gjaku, në cep të minderit, u ngrinte ndër dej" të këputura nga barra e shumëfishtë e shekujve, i thanë tmerrit të shtyhej tutje dhe tokës shqiptare i falën shumë fatosa me të cilët do të mund të mburreshin shumë kombe të mëdha.

"Shpirti në gjirize, ç'duan në tokat e shqiptarëve"? pat klithur gjyshja e Mic Sokolit për sllavët, nëna e Azem Galicës, vetë Azemi me të shoqen, heroinën Shotë dhe patën rrokur armët kundër serbit e malazezit, armët me të cilat i lanë nam Shqipërisë dhe i futën tmerrin armikut që po ia shkretonte tokat dhe njerëzinë.

Shpirti në gjirize, ç'duan në tokat e shqiptarëve – i ra hise të thotë po për këta sllavë shovinistë edhe gruas së sotme shqiptare, kosovares së re dhe të futet drejtpërdrejtë në frontin e sotëm të luftës politike, me perspektivë fare të afërt për t'u shndërruar në një konflikt të armatosur, në luftë nacionalçlirimtare.

Me indinjatën e thellë për torturat që i bëhen sot kosovares në burgjet jugosllave, po me zemër të gufuar për aktin e saj të ndritshëm historik të inkuadrimit direkt në çështjen e madhe të lirisë, i falenderohemi, nënës, motrës, gruas shqiptare që na e forconi krahun e luftës dhe jemi të bindur se qysh sot mund t'ia themi të gjithë së bashku këngës:

Ik, o natë, po këndon agimi…

(Jusuf Gërvalla, Bashkimi, prill 1980, faqe 3. Ky artikull është ribotuar edhe në numrin dy të Lajmëtarit të lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 13-14)

3-5.Ylli i pashuar në qiellin shqiptar

LUFTOI DHE MBETI YLL I PASHUAR NË QIELLIN SHQIPTAR

Epitafi në gurin e varrit të Jusuf Gërvallës në Shtutgart i shkruar nga Xhafer Durmishi

3-6.YJET E PAVDEKËSISË së Faridin Tafallarit

Majtas Rifat Jashari, Abdyl Krasniqi (babai Xhevë Krasniqit-Lladrovci), Faridin Tafallari, verë 1999

Abdyl Krasniqi dhe Faridin Tafallari në Prizren, prill 2004,
në promovimin e librave të Faridin Tafallarit

Fehmi Lladrovci dhe Xheva (bija e Abdyl Krasniqit)



Redaktor & Korrektor: Fatmira Shalari
Grafik & Design: Henrik Baçi

Faridin Tafallari*: "Me rastin e botimit të librit tim: ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, NË ATO VITE TË STUHISHME", dëshiroj të falënderoj Xhafer Durmishin, i cili e ka lexuar përmbajtjen e librit në dorëshkrim, dhe përkundër qëndrimeve të tij, megjithëse ende të pashprehura publikisht në tërësi, pa rezervë më ka bërë vërejtje, të cilat i kam marrë parasysh. Pjesën e tretë, të fundit, Xhafer Durmishi nuk e ka komentua".*

3-7.Shuarja dhe vdekja e yjeve si burim jete

Yjet janë versione të largëta të Diellit tonë —topa të zjarrtë të gazrave të patejdukshëm të mbajtur të përmbledhur nga gravitacioni. Reaksionet nukleare ndodhin thellë në qendër, prej nga e ka burimin drita të cilën ne e shohim.

Përmes observimeve studimore të yjeve nëpër faza të ndryshme të jetës së tyre dhe përdorimin e fizikës së gazrave të mbajtura bashkë nga gravitacioni, astronomët mund ta parashikojnë me përpikmëri probabilitetin e evolvimit të yjeve.

Reaksionet bërthamore

Shkencëtarët besojnë se elementet më të rënda kimike nuk mund të krijohen në ndonjë mënyrë tjetër pos me rastin e një eksplodimi supernova. Këtu bëhet fjala për atome më të rënda se hekuri, p.sh. ari. Kjo ndodhë për shkak se këto atome të rënda nuk mund të krijohen veçse në temperatura aq të larta, prej qindra miliardash gradë Celzius. Këto temperatura arrihen vetëm në supernova eksplodime.

Elementet kimik që janë të rëndësishëm për jetë, si oksigjeni dhe karboni, mund të krijohen në yje, por për shpërndarjen e tyre në gjithësi, supernova-t luajnë rol të rëndësishëm.

Një supernova mund ta rrisë ndriçueshmërinë deri në 10 miliardë herë më shumë se Dielli. Në maksimumin e ndriçueshmërisë supernova mund të bëhet si rivale të gjitha yjeve marra së bashku të një galaksie. Gazrat e yllit eksplodues hidhen me shpejtësi më të mëdha se 10 000 km në sekondë, gjë që mund të përcaktohet nga spektri i supernova-ve.

Nga horizonti njerëzor, aspekti më i rëndësishëm i supernova-ve është se ato krijojnë dhe shpërndajnë në gjithësi, elementet kimike prej të cilave ndërtohet jeta. Edhe pse me temperatura të larta, Universi i hershëm (i ashtuquajturi Big Bang) ka prodhuar vetëm hidrogjen dhe helium. Të gjitha elementet më të rënda janë krijuar në brendësinë e yjeve.

Sikur disa yje të mos eksplodonin, në atë rast të gjitha elementet kimike të rënda do të mbeteshin të mbyllur brenda *white dwarfs,* të paarritshme, të padisponueshme si lëndë e parë, pa të cilat nuk do të vinte tek krijimi i yjeve të reja, planeteve të reja, nuk do të vinte as edhe tek krijimi i jetës në Tokë.

3-8.DIELLI

Shpesh mund të shtrohet pyetja; A është Dielli ynë një yll i gjeneratës së dytë? A është i gjeneratës së tretë? Prej cilës supernova e kemi prejardhjen? Nuk ka përgjigje të thjeshtë në këto pyetje. Është një përzierje e yjeve eksploduese që i krijon bujashkat-mbetjet në galaksi. Mbetjet prej shumë eksplodimeve përzihen, bashkëshkrihen dhe kështu formojnë një re tkurrëse gazrash dhe pluhuri që krijon formimin e yjeve dhe planeteve. Disa prej yjeve që kanë kontribuar në ato re kanë pasur jetë të shkurtë. Yjet masive kanë jetë të shkurtë dhe eksplodojnë një kohë të shkurt pas lindjes; yje të tjerë kanë jetë më të gjatë para se të eksplodojnë.

Kështu, kanë qenë shumë lloje gjeneratash të ndryshme të cilat kontribuar në formimin e reve të gazit prej të cilit është formuar Sistemi ynë Diellor.



Rreth tri të katërtat e masës së diellit përbëhet nga hidrogjeni (73%) pjesa tjetër më së tepërmi është helium (25%), dhe sasi të vogla të elementeve më të rënda duke përfshi oksigjenin karbonin, neon dhe hekur.

Temperatura e lartë në pjesët e bërthamës së diellit llogaritet të jetë 15 milion °C, që mundëson krijimin e heliumit (He) nga hidrogjeni H). Se me të vërtetë ndodh fusioni në bërthamën e diellit është vërtetuar nga neutrinet prej dielli. Procesi i fusionit e mban të lartë temperaturën në brendësinë e diellit. Nga bërthama e diellit energjia vonon nga 50 000 deri në 100 000 vjet derisa të mbërrij në sipërfaqe dhe të rrezatoj në hapësirë.

Dielli është një yll i llojit *G-type*, informalisht i quajtur *yellow dwarf*, megjithëse drita e tij faktikisht është e bardhë. Është formuar para 4,6 miliard vitesh prej kolapsit gravitacional të materies në një regjion të madh me re molekulare. Pjesa kryesore e materies është mbledhur në qendër, ndërsa pjesa tjetër ka marrë formën e diskut që sillet përreth që është Sistemi Diellor. Pjesa e brendshme është bërë aq e dendur dhe me temperatura të larta, të cilat kanë ndikuar në fillimin e fusionit bërthamor në qendër të diellit.

Pra me nisjen e proceseve bërthamore të fusionit në qendër mund të themi se fillon jeta e Diellit, fillon jeta e një ylli.
Çdo sekondë në bërthamën e diellit bëhet fusionimi i 600 miliard kg të hidrogjenit në Helium, dhe bëhet konvertimi i 4 miliard kg materie në energji.

Pas 4 deri në 7 miliard vjet, kur fusioni i hidrogjenit do të zvogëlohet deri në atë shkallë sa Dielli nuk është më në ekuilibër hidrostatik, bërthama kalon nëpër një ngritje të dendësisë dhe temperaturës që do të ndikoj në zgjerimin e shtresave të jashtme, duke e shndërruar Diellin në një *red giant*. Pas *red giant*-fazës, modelet sugjerojnë se Dielli do t'i hedhë shtresat e jashtme dhe do të bëhet një *white dwarf*, që nuk prodhon më energji përmes fusionit por në formë gace do të jep nxehtësi prej fusionit të mëparshëm për trilion vite. Sipas teorive, pas asaj kohe do të bëhet *black dwarf* i dendur, me *energy* të neglizhueshme.

3-9.Drita

Drita, drita e dukshme, apo rrezatimi i dukshëm është rrezatim elektromagnetik që perceptohet nga syri i njeriut. Drita e dukshme shtrihet në spektrin e dukshëm me gjatësi valore prej 400-700 nanometrash, e frekuencë korresponduese prej 750-420 terahertz.

Në këtë kuptim, rrezet gama, rrezet X, mikrovalët dhe radiovalët janë gjithashtu dritë. Vetitë themelore të dritës janë intensiteti, drejtimi i përhapjes, frekuenca apo spektri i gjatësisë valore dhe polarizimi.

Shpejtësia e dritës në vakum është 299792458 m/s, është një prej konstantave fundamentale të natyrës. Si dhe të gjitha llojet e rrezatimit elektormagnetik, drita e dukshme shpërndahet prej *massless elementary particles* të quajtur fotone, që reprezentojnë quanta të fushës elektromagnetike dhe mund të analizohen si *waves and particles*.

Në fizikë, termi ”dritë” mund të përfshij më gjerësisht rrezatimet elektromagnetike të çdo gjatësie valore, pa marrë parasysh se a është e dukshme apo jo.

Burimi kryesor i dritës në Tokë është Dielli. Historikisht, tjetër burim i dritës për njerëzit ka qenë zjarri, prej kohërave më të hershme e deri te fitilat e llampës, të zëvndësuara nga drita elektrike.



Spektri elektromagnetik. Pjesa e dukshme e spektrit, në pjesën e poshtme të grafikonit të mësipërm, është me ngjyra. Gjatësia valore është dhënë në nanometra (nm).

10. DIGA E DRINIT dhe DRITA E DRINIT

DIGA E DRINIT

Diga e Drinit-Nexhmedin Zajmi, Galeria e Arteve Tiranë, 1966

YJE MBI DRIN

Zana dhe Drita e Yjeve mbi Drin
Yje mbi Drin, Kinostudioja "SHQIPËRIA E RE", Tiranë 1978
Skenari i Muharrem Skenderit dhe Halil Kamberit

Drita e Drinit



Suzana dhe Jusuf Gërvalla

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla:" "Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"
Të dashur shokë!

Udhëtimin e Shpendit e quajtëm si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm. Ditën kur u kthye Shpendi pra të hënën, ditën e parë të javës, kur shokët ia filluan javës së re të punës.

Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishin farë automjeti, mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirr gjer më 26 shkurt 1982. Atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën: Shpendi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Drita (Suzana Gërvalla), Agimi (Nuhi Sylejmani), Agroni dhe Guximi (Haxhi Berisha).

Mbledhjen e hapi Shpendi i cili në fillim i ***njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën*** *e re dhe me detyrën e qëllimin e ardhjes së Halimit.*
Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:
Formimi i degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore.
a) Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet "Komiteti Vëllezërit Gërvalla".
b) Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë
Të ndryshme
Ky rend dite u aprovua njëzërit nga të pranishmit.
1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit, pra pesë veta. Meqë Agimi ishte edhe më parë si arkatar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe Shpendin nuk u diskutua

shumë rreth tyre se a duhet të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që Komiteti t'i ketë edhe dy kandidatë. Ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimi që në fillim tha se pyetjen për arkatar nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkatarin e vyeshëm e kemi që nga fillimi. Propozimi i Arsimit që edhe më tutje të jetë arkatar Agimi i aprovua.

Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoj në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. *Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e mori Drita e cila u falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se* ***Shpendi ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ të ish-LNÇKVSHJ****. Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore. Edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan. Për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.*

Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet Halimi. *Ndërsa anëtarë i ri i komitetit do të jetë Arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të zgjidhet Luli.*

a) Propozimi që komiteti të quhet "Vëllezërit Gërvalla" u aprovua njëzërit.

b) Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari i ri Halimi edhe ca anëtarë të tjerë të ish-LNÇKVSHJ nuk dinin shumë në lidhje me përbërjen në numër të një komiteti, mbretëroi pak heshtja. Me këtë rast Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon qe disa vjet dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperiencë lidhur me funksionimin e një komiteti të tillë sidomos në kushtet jashtë atdheut dhe pasi ne ishim të pranishëm tetë ndërsa komiteti do të kishte vetëm pesë anëtarë. Halimi tha se faktikisht për anëtarët e këtij komiteti po dinë 8 veta. Ai tha se edhe ata aktivist të dalluar të jen si kandidat për komitet. Ky propozim dhe arsyetimi i cekur më lartë u pranua. Pra komiteti i degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla" për Evropën Perëndimore ka me shkuarjen e Dritës ai do të duket kësisoji:

1. Shpendi	*Kryetar*	*Xhafer Durmishi*
2. Drita/Halimi	*Sekretar*	*Suzana Gërvalla/Osman Osmani*
3. Agimi	*arkatar*	*Nuhi Sylejmani*
4. Agroni	*anëtarë*	*Faridin Tafallari*
5. Halimi	*anëtar*	*Osman Osmani*
6. Halili	*kandidat*	*Hafiz Gagica*
7. Guximi	*kandidat*	*Haxhi Berisha*
8. Arsimi	*Përgjegjës i rinisë*	*Naim Haradinaj*

2) Në pikën të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, çështjet materiale, puna rreth vendosjes në një bazë të re dhe nxjerrjes sa më të shpejtë të numrit të ri të organit.
Për këto dhe të tjerat herën e ardhshme.
Ju përshëndesin shokët e "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"
Kosova – Republikë" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358)

***

Në Tokë lëvizim me shpejtësi përmbi një central bërthamor. Janë forcat bërthamore që veprojnë nga brendësia, që e mbajnë brendinë e tokës në atë gjendje si është dhe e ekuilibrojnë forcën e gravitacionit që vepron nga jashtë. Nga formulat e Albert Einsteint, shkencëtarët thonë se ne lëvizim me shpejtësinë e dritës në boshtin kohor, në drejtimin kohor të diagrameve *SPACETIME*.

Drita me shpejtësinë e vetë është lajmëtare, fotonet janë lajmëtare, dhe lajmi e *Lajmëtari i lirisë* nuk mundet me u shpërnda me një shpejtësi më të madhe se 300 000 km/sekond.

Shpejtësia e dritës është vendimtare pse kemi DRITË-HIJE.

Shkaku vendimtar pse kemi dritë-hije, pse kemi NATË nuk qëndron në shkakun e rrotullimit të tokës rreth boshtit të vetë, kur një pjesë e Tokës ia kthen shpinën DIELLIT, apo pse e kemi vetëm një Yll. Shkaku kryesor qëndron në atë se yjet e tjera të gjithësisë, me miliarda e miliarda janë tepër larg, dhe drita e tyre nuk mbërrin tek ne.

Kështu duket bota nga perspektiva jonë, nga - *our Frame of reference.*

Shkencëtarët mendojnë drita nuk ka -*Frame of reference*- të vetin, por një kombinim i formulave të Albert Einsteinit me ato të integraleve (me limite) na sjellin deri tek ideja, se drita mund të jetë e pranishme kudo.

Sipas teorisë së relativitetit të Einsteinit,

-hapësira është një madhësi relative, e ndryshueshme,

-koha është një madhësi relative, e ndryshueshme.

E vetmja konstantë, që është e njejtë për të gjithë, pa marrë parasysh vendin dhe kohën është shpejtësia e dritës.

***

Si përfundim dua ta potencojë edhe njëherë se qëllimi im me këtë libër, ashtu edhe si më parë, është që, brenda kufijve të aftësive të mija, të argumentoj për të vërtetën e një kohe që ka ndodhë para 40 vitesh. Ndërtimi e orientimi në politikat partiake aktuale, u takon atyre udhëheqësve që merren jo vetëm me përpilim programesh por para së gjithash për atë se ata janë në mesin e popullit.

==========

==========

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

Xhafer Durmishi-Skenderi

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror."* (14 janar 1981)

Shaban Muharremi: "*Xhafer Durmishi është vlerë dhe krenari kombëtare e veçantë, është yll që do t'u shndris brezave! Edhe 25 veprat e tij për ngjarjet në Shtutgart dhe më gjerë, janë dëshmi e pakontestuar dhe e pastër si loti që ai po ia le historisë tonë. Personaliteti i tij kalon baladën për Gjergj Elez Alinë, ndërsa pena e tij, është penë e Marin Barletit të kohës moderne."*

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Shkurt 2025-Shkurt 2026